

Udhëzues

PËR PUNËN

E KËSHILLEVE KOMUNALE



Mission to Serbia

ORGANIZATION FOR SECURITY
AND CO-OPERATION IN EUROPE

*për
marrëdhënie
ndërnacionale*

Goran Bašić

Udhëzues për punën e
këshilleve komunale për
marrëdhënie ndërnacionale



Beograd, 2006.

Udhëzues për punën e këshilleve ndërnacionale

edicioni i parë

Editori:

Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave

www.skgo.org

Donatorë:

Misioni i OSBE-së në Serbi

Për editorin:

Dorđe Staničić, sekretar gjeneral i KPQK

Autorë:

Goran Bašić

Këshilli drejtues:

Shaun R. Barcavage,

këshilltar për administratën publike, Misioni i OSBE-së në Serbi

Jasmina Krunic Pasku,

këshilltare në Projekt, Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave

Salman Haq

OSBE/CANADEM jurist/praktikant

Željko Jovanović,

bashkëpunëtor në Projekt, Misioni i OSBE-së në Serbi

Irina Schmakova,

OSBE/CANADEM juriste/praktikante

Përgatitja dhe shtypi:

DOSIJE, Beograd

Tirazhi:

300

ISBN: 86-82455-40-4

Beograd, Nëntor 2006

Ky udhëzues u publikua duke iu falënderuar përkrahjes së Misionit të OSBE-së në Serbi dhe donacioneve të shteteve anëtare të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja e këtij Udhëzuesi shprehë qëndrimet dhe mendimet e autorëve të cilat nuk duhet që patjetër të përshtaten me qëndrimet e Misionit të OSBE-së.

Originalno izdanje ove publikacije objavljeno je na srpskom jeziku, u izdanju Stalne konferencije gradova i opština, u Beogradu, 2006 godine.

Najlepše se zahvaljujemo Misiji OEBS i vojvođanskom Sekretarijatu za upravu, propise i nacionalne manjine na pomoći pri prevođenju publikacije na jezike manjina.

The original version of this booklet is published in Serbian language by the Standing Conference of Towns and Municipalities, in Belgrade, 2006.

We would like to thank the OSCE Mission to Serbia as well as the Provincial Secretariat for Regulations, Administration and National Minorities of Vojvodina for helping with the translation of the booklet in to additional languages.

Parathënie

Nga Tetori i vitit 2000, Serbia po kalon nëpër reforma ekonomike, politike dhe sociale në të cilat procesi i decentralizimit është bërë një nga qëllimet kryesore në rrugën drejt demokratizimit. Ky proces nënkupton bartjen e kompetencave, përgjegjësisë dhe mjeteve nga strukturat qendrore, në komuna dhe qytete, duke përforcuar në këtë mënyrë autoritetet lokale dhe duke iu mundësuar që problemet e veta ti zgjidhin në mënyrë më efektive. Ligji për vetqeverisjen lokale, i aprovuar në Shkurt të vitit 2002, ka sjellur një numër të caktuar të risive në lidhje me organizimin e sistemit të ri dhe organeve të autoriteteve lokale. Në mes të këtyre iniciativave, harmonizimi i interesave të grupeve të ndryshme etnike përmes krijimit të trupave të reja është në fokus të realizimit të decentralizimit në Serbi.

Ligji për vetqeverisjen lokale parasheh themelimin e Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale— trupave lokale kompetenca kryesore e të cilave është të mbrojë dhe të avancojë barazinë etnike në komunat multietnike.

Gjatë procesit të përgjithshëm të ndërtimit të ambientit demokratik në Serbi, Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave (KPQK) iu është përkushtuar avancimit dhe zhvillimit të vetqeverisjes lokale, duke përkrahur interesat e veta dhe duke promovuar bashkëpunimin e autoriteteve lokale. Në lidhje me këtë, KPQK në bazë të Projektit përkrahje komunave, i cili realizohet me anën e finansimit të Misionit të OSBE-së në SMZ, iu nënshtroa hartimit të Udhëzuesit për punën e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale, të cilin ua prezantojmë me kënaqësi.

Ky udhëzues është rezultat i konsultimeve në mes të Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi, KPQK-së, Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetqeverisje lokale, dhe Qendrës për hulumtimin e etniciteteve, ka për qëllim sigurimin e përkrahjes së komunave etnikisht të përziera në përpjekejet e tyre të ndërtojnë një rreth tolerant etnik në të cilin të gjithë qytetarët i gëzojnë të drejtat e njejta. Këtë e bën duke përmbledhur informata për përbërjen etnike të Serbisë, si dhe kornizën ligjore vendore dhe ndërnacionale në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave, duke iu ofruar këshilla komunave multietnike në pikëpamje të punës së këshilleve.

Udhëzuesi përfshin edhe studime të rasteve të realizuara nga vizita nëpër komuna të caktuara. Këto studime mund të jenë të një rëndësie të vecantë, pasi që përshkruajnë përvoja të komunave serbe– pionier në themelimin e Këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale. U ofrua gjithashtu edhe lista e sugjerimeve të paobligueshme të cilat kanë të bëjnë me themelimin dhe funksionimin e Këshilleve, të cilëve u sugjerohen zgjidhje të mundshme të problemeve të cilat mund të praqiten në aktivitetet tuaja të përditshme.

Sipas ligjit për vetqeverisjen lokale, kuvendet e komunave kanë pavarësi në shfrytëzimin konstruktiv të kornizës ligjore të tanishme për t'i bërë Këshillet trupa më efikas të vetqeverisjes lokale në komunat multietnike. Prandaj, shpresojmë që ky udhëzues do tju shërbejë si mjet i vlefshëm në aktivitetet e përditshme të këshilleve tuaja.

Jemi të hapur për sugjerimet tuaja dhe idetë për përmirësimin e praktikës prezente, duke ju përkrahur që së bashku të punojmë në ndërtimin e vetqeverisjes lokale më demokratike dhe më tolerante në Serbi.

Gjorgje Staniçiq
Sekretar Gjeneral i KPQK

Përmbajtja

1. Hyrja	9
Qëllimi i Udhëzuesit	9
Si u krijua Udhëzuesi?	11
Terminologjia	11
Si të lexohet dhe të shfrytëzohet Udhëzuesi?	13
2. Baza ligjore për themelimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale në komunat multietnike	16
Ligji për vetqeverisjen lokale – neni 63	16
Komunat multietnike në Serbi	20
3. Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale në komunat multietnike	25
Komunat në të cilat janë themeluar këshillet për marrëdhënie ndërnacionale	25
Themelimi i këshillit dhe zgjedhja e anëtarëve	28
Proçesi i themelimit të këshillit	28
Praktika e njërive të vetqeverisjes lokale	30
Propozimi dhe zgjedhja e anëtarëve nga radha e pakicave nacionale	30
Propozimi dhe zgjedhja e anëtarëve nga bashkësia nacionale serbe	35
Pjesëmarrja qytetare në punën e këshillit	37

Dilemat e vetqeverisjes lokale në lidhje me themelimin e këshilleve dhe zgjedhjen e anëtarëve. . .	38
Kush janë „shfrytëzuesit“ e nenit 63?	38
Kush i propozon anëtarët e këshillit?	40
Cilat bashkësi janë të përfaqësuara në këshill?	40
Kompetencat e këshillit	40
Kompetencat themelore	41
Kompetencat e definuara me vendimin e kuvendit të komunës	42
Praktika e vetqeverisjes lokale në lidhje me kompetencat.	45
Dilemat në lidhje me kompetencat e këshillit.	46
Cilat janë kompetencat e këshillit?	46
Përpuhtja e kompetencave	47
4. Propozime në lidhje me themelimin dhe punën e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale . . .	53
Propozimet e përgjithshme.	54
Rekomandime në lidhje me procesin e themelimit të këshillit.	55
Rekomandime në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve	56
Rekomandime në lidhje me kompetencat	57
Propozimet në lidhje me mënyrën e punës	59
5. Në vend të konkludimit	61
Shtojca 1: Struktura etnike e Serbisë	62
Shtojca 2: Mbrojtja e të drejtave të pakicave nacionale	72

1

Hyrje

QËLLIMI I HYRJES?

Pas aprovimit të Ligjit për vetqeverisjen lokale, në Shkurt të vitit 2002, në praktikën tonë shoqërore dhe ligjore u themeluan institucione të cilat nuk kanë ekzistuar deri atëherë. Njëkohësisht komunave iu lejuan kompetenca me të cilat do të duhej udhëhequr në mënyrë autonome. Qëllimi i këtyre masave është realizimi i decentralizimit dhe dhënia e kompetencave të reja komunave në procesin e forcimit të demokracisë lokale. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi, është iniciativa qytetare, respektivisht forcimi i përgjegjësisë së qytetarëve për gjendjen në bashkësitë lokale në të cilat jetojnë. Në institucionet e sapoformuara është këshilli për marrëdhënie ndërnacionale, i cili nën rregullat e shënuara me Ligjin për vetqeverisjen lokale themelohet në komunat me popullatë kombësisht të përzier. Në kuptimin më të ngushtë qëllimi i themelimit të këshilleve është të shqyrtojë vendimet e kuvendit të komunës, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e barazisë së pakicave nacionale dhe në lidhje me këtë të japë mendime dhe të fillojë iniciativa për mbrojtjen e të drejtave të tyre, të parapara me ligj.

Në kuptimin më të gjerë, funksionet e këtyre trupave mund të merren edhe me çështje të tjera në lidhje me stabilitetin shoqërorë në bashkësitë lokale: preventivën dhe zgjidhjen e konflikteve,

promovimin e tolerancës dhe respektimin e llojllojshmërisë dhe krijimin e dalogut ndëretnik. Në kuptim të nenit 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale, e vetëm në 18 komuna u themeluan këshillat për marrëdhënie ndërnacionale. Në komunat në të cilat janë formuar këto trupa janë të dukshme problemet në pikëpamjen e funksionimit të tyre, zgjedhjen e anëtarëve të këshillit etj. Udhëzuesi për punën e kësillove për marrëdhënie ndërnacionale iu është dedikuar anëtarëve të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale dhe personave kompetent në njësitë e vetqeverisjes lokale që duhet ti udhëzojë në kuptime themelore, vendime ligjore dhe procese me të cilat ballafaqohen anëtarët e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale. Ky tekst duhet të kontribuojë në menxhimin më të lehtë në lidhje me çështjet të cilat kanë të bëjnë me realizimin e barazisë nacionale. Me këtë rast duhet të kihet parasysh që në njësitë e vetqeverisjes lokale shumica e bashkësive komëtare mund të jetë në pozitë të pakicave, por edhe ajo që shumica e kompetencave të këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale. Në këtë kuptim, qëllimi themelor i Udhëzuesit është ti ndihmojë kuvendëve të komunave dhe qytetarëve të njohin nevojën për themelimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale, dhe të udhëzojë personat kompetent në mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit dhe përshkrimin e punës së këtij trupi, por edhe të tregojë për problemet ekzistuese dhe të mundshme dhe pengesat. Udhëzuesi përmban propozime për avancimin e punës, themelimin dhe funksionimin e këshilleve, por ato nuk duhet të kuptohen vetëm si model i njëanshëm të cilin duhet aplikuar me çdo kusht dhe pa kritika.

Në fakt fjala është për gjëra të cilat në situata të caktuara mund të ndihmojnë me rastin e mënjanimin të dilemave eventuale. Vlera themelore e këtyre propozimeve është ajo që shumica e tyre kanë dalur nga praktika e këshilleve ekzistuese për marrëdhënie ndërnacionale dhe vërejtjet dhe propozimet të cilat i kanë vënë

re anëtarët e këshillit, këshilltarët në kuvendet e komunave dhe qytetarët në komunat multietnike.

SI U KRIJUA UDHËZUESI?

Në bazë të fazës së dytë të projektit përkrahje komunave të cilin e realizon Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi, është planifikuar përgatitja dhe publikimi i Udhëzuesit që mund t'i ndihmojë komunave multietnike me rastin e themelimit dhe funksionimit të këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale. Duhet përmendur se hulumtimet të cilat e kanë përcjellur hartimin e këtij Udhëzuesi si dhe vetë tekstin u bënë në tre muajt e vitit 2005. Në atë periudhë u bë hulumtimi në 12 komuna në të cilat u formuan këshillet për marrëdhënie ndërnacionale dhe në 4 komuna në të cilat procesi i themelimit të këshilleve ishte në rrjedha e sipër. Të dhënat e tjera u arritën me anën e analizës së statuteve komunale dhe dokumenteve tjera të aprovuara në Shkurt të vitit 2002, dhe deri në fund të vitit të kaluar nga hulumtimi i Demokracisë lokale dhe menaxhimi në bashkësitë lokale multietnike në Serbi të cilën e realizon Qendra për hulumtimin e etniciteteve.

TERMINOLOGJIA

Në tekstin e Udhëzuesit përdoren terme të ciat më afër e caktojnë vendin, rolin dhe qëllimin e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale. Shumica e këtyre nocioneve është e njohur dhe mundet në varësi nga disiplina dhe baza teorike të interpretohet në mënyra të ndryshme. Në këtë vend tregohet për interpretime të termeve kyçe në kuptim të ligjit dhe praktikës në Serbi.

Komuna e përzier kombësisht (komuna multietnike)

Si komuna kombësisht të përziera konsiderohen ato komuna në të cilat bashkësia nacionale përbën më shumë se 5% nga numri i përgjithshëm i popullatës ose të gjitha bashkësitë përbëjnë më shumë se 10% sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Republikën e Serbisë (Ligji për vetqeverisjen lokale).

Pakica nacionale

Pakicë nacionale është çdo grup i shtetasve të Republikës Federale të Jugosllavisë, e cila sipas numrit është mjaft reprezentuese, edhe pse paraqet pakicë në territorin e Republikës së Jugosllavisë, i takon ndonjëres nga grupi i popullatës të cilët janë në lidhje të gjatë dhe të fortë me territorin e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe posedon shenja siç janë gjuha, kultura, përkatësia nacionale ose etnike, origjina ose feja me të cilat dallohet nga shumica e banorëve dhe anëtarët e së cilës përpiqen që së bashku të mirëmbajnë identitetin e vet të përbashkët, duke përfshirë kulturën, traditën gjuhën ose religjionin. Si pakica nacionale do të konsiderohen të gjitha grupet e shtetasve të cilët thirren ose përcaktohen si popuj, bashkësi nacionale dhe etnike, grupe etnike dhe nacionale, kombësi... (Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale në RF të Jugosllavisë, (neni 2.).

Bashkësia nacionale

Ky nocion edhe pse lajmërohet në nenin 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale dhe Rregulloren mbi punën e Kuvendit

popullor të Republikës së Serbisë nuk është defnuar në sistemin tonë ligjor. Përdoret nga termi popullor dhe me këtë qëllim mund të shënohet si grup i njerëzve të origjinës së njejtë etnike i cili jeton në Serbi dhe ka shtetin amë nacionale.

Bashkësia etnike

Si edhe nocioni i mëparshëm, nuk është i bazuar në ligj. Për kuptimin më të lehtë të tekstit e përdorim si term i cili e nënkupton grupin e njerëzve të origjinës së përbashkët etnike të cilët nuk kanë shtet të vetin.

SI TË LEXOHEËT DHE TË PËRDORET UDHËZUESI?

Në udhëzues janë sqaruar nocionet themelore në lidhje me institucionin e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale, përvojat e komunave të cilat i kanë themeluar këto trupa dhe punën e tyre, kurse janë shprehur edhe propozime të cilat duhet të ndihmojnë në lidhje me formimin e këshillit, kompetencat e këtyre trupave dhe rolit të tyre në procesin e zhvillimit të demokracisë lokale. Duhet kushtuar kujdes atyre pjesëve të Udhëzuesit që tregojnë shembuj nga praktika e mirë, por edhe dilemat me të cilat ballafaqohen njësitë e vetqeverisjes lokale në lidhje me punën e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale. Në kapitullin e parë hyrës, lexuesit i tregohen idetë themelore në lidhje me qëllimin dhe strukturën e Udhëzuesit, dhe bëhet fjalë edhe për terminologjinë dhe veprimet metodike me të cilat

janë grumbulluar dhe analizuar të dhënat në lidhje me punën e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale. Në kapitullin e dytë të Udhëzuesit është përshkruar marrëdhënia ligjore e themelimit të këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale dhe me radhë janë përmendur komunat multietnike në Serbi. Kapitulli i tretë është synimi i Udhëzuesit dhe materia është koncentruar në disa pjesë të cilat tregojnë për kushtet të cilat Ligji për vetqeverisjen lokale i ka vënë në lidhje me themelimin, punën dhe kompetencat e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale. Në kapitull është theksuar praktika e mirë në komunat multietnike në lidhje me punën e këshilleve, por edhe problemet dhe dilemat me të cilat ballafaqohen njësitë e vetqeverisjes lokale.

Në kapitullin e katërt janë rekomandimet në lidhje me avancimin e punës së këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale por edhe rekomandimet në bazë të së cilave njësitë e vetqeverisjes lokale në mënyrë më efektive do të mund t'i uqasen edukimit të këshillit, respektivisht aprovimit të vendimeve të duhura, kandidimit, zgjedhjes së anëtarëve dhe respektimit të procedurës.

Më në fund, pas vështrimeve të shkurtëra përfunduese hasim në dy tekste shtesë, nga të cilët i pari tregon për strukturën etnike në Serbi, si dhe në komuna të cilat sipas nenit 63 të Ligjit për vetqeverisje lokale janë komuna multietnike.

Shtojca tjetër iu është dedikuar mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale. Edhe pse ideja themelore në lidhje me punën e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale nuk ka të bëjë kryesisht me pakicat nacionale por me bashkësitë nacionale, në mesin e të cilave bien edhe bashkësia serbe dhe malazeze, në praktikë, punët e këshillit më së shpeshti kanë të bëjnë me problemet e pjesëtarëve të pakicave nacionale. Duke u munduar që anëtarët e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale t'i fusë në materien e komplikuar të mbrojtjes së të drejtave të pakicave,

Udhëzuesi përpunon standarde ndërnacionale të kësaj mbrojtjeje, instrumente që janë paraparë në sistemin vendor kushtetutoligjor dhe më në fund, realizimi i të drejtave të pakicave në njësitë e vetqeverisjes lokale.

Baza

2

ligjore për themelimin e
këshilleve për marrëdhënie
ndërnacionale në komunat
multietnike

LIGJI PËR VETQEVERISJEN LOKALE – NENI 63

Në mes të përpjekjeve për të avancuar marrëdhëniet ndërnacionale në bashkësitë lokale është neni 63. i Ligjit për vetqeverisje lokale. Me¹ këtë nen në jetën

1 „Në komunat kombësisht të përziera themelohet këshilli për marrëdhënie ndërnacionale të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e të gjitha bashkësive etnike. Komuna kombësisht të përziera, në kuptim të këtij ligji konsiderohen komunat në të cilat një bashkësia nacionale përbën më shumë se 5% të numrit të përgjithshëm të popullatës ose të gjitha bashkësitë përbëjnë më shumë se 10% sipas regjistrimit të fundit të popullatës në Republikën e

ligjore dhe shoqërore u fut institucioni i këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale, të cilët duhet të përcjellin gjendjen dhe të merren me çështjet e realizimit, mbrojtjes dhe avancimit të barazisë nacionale në bashkësitë lokale.

Sipas nenit 1. të këtij ligji është e paraparë që në „komunat kombësisht të përziera të themelohet këshilli për marrëdhënie ndërnacionale të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e bashkësive të të gjitha kombeve dhe etniciteteve“ . Prandaj, ligjdhënësi qartë ka vërtetuar obligimin e komunave me përbërje kombësisht të përzier të popullatës që të themelojnë këshillin për marrëdhënie ndërnacionale, por duke respektuar principin e autonomisë së njësive të vetqeverisjes lokale ka vërtetuar një kornizë fleksibile

Serbisë. Përfaqësues në këshillet për marrëdhënie ndërnacionale mund të kenë të gjitha bashkësitë me më shumë se 1% të pjesëmarrjes nga numri i pergjithshëm i popullatës së komunës.

Këshilli shqyrton çështje të realizimit, mbrojtjes dhe avancimit, në pajtim me ligjin dhe statutin.

Këshilli për qëndrimet dhe rekomandimet e veta e lajmëron kuvendin e komunës e cila është e obliguar që për ato të japë sqarime në kuvendin e parë të ardhshëm, e më së largu në afat prej 30 ditëve.

Kuvendi i komunës është i obliguar që me propozim të të gjitha vendimeve të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike paraprakisht të bëjë me dije këshillin për merrëdhënie ndërnacionale.

Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale ka të drejtë që përpara Gjyqit kushtetues të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutësisë dhe legjislacionit të vendimit ose të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës nëse mendon se atyre iu janë thyer të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike të prezantuar në këshillin për marrëdhënie ndërnacionale dhe të drejtën që nën kushtet e njehta përpara Gjyqit kushtetues të fillojë procedurën për vlerësimin e pajtueshmërisë së vendimit ose ndonjë akti tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës me statut të komunës.

Fushëveprimi, përbërja dhe mënyra e punës së këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale rregullohet me vendimin e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin

të themelimit të tyre. Njësitë të vetqeverisjes lokale iu la që të zgjedhin anëtarët e këshillit dhe të konkretizojnë kompetencat e tyre të parapara me ligj.

Në praktikë kjo do të thotë që komunat, të cilat sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullatës përmbushin kriteriumet e multietnicitetit, respektivisht që në to të jetë e vendosur më shumë se 5% e popullatës së një bashkësie nacionale e Republikës së Serbisë, kanë më shumë se 10% të numrit të përgjithshëm të popullatës së përgjithshme të komunës, duhet që në statutet e veta të parashohin themelimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale (neni 63. alinea 2).

Me qëndrimin e ligjit të njejtë precizohet që përfaqësuesit „në këshillin për marrëdhënie ndërnacionale mund të kenë bashkësitë me më shumë se 1% të pjesëmarrjes nga numri i përgjithshëm i popullatës së komunës.

Ky formulim është në kundërshtim me alinenë e parë të përmendur nga ligji i njejtë i cili qartë përcakton që në këtë trup janë përfaqësuar përfaqësuesit e të gjitha bashësive nacionale dhe etnike. Nuk është e qartë pse ligjdhënësi ka përdorur dispozita kundërshtuese dhe me këtë ka mundësuar interpretime të ndryshme.

Edhe pse ligjdhënësi në alinenë 8. ka paraparë që fushëveprimin e punës së këshilleve e përcakton kuvendi i komunës me vendim të posaçëm, baza e fushëveprimit është caktuar në alinenë 4. „këshilli shqyrton çështjet e realizimit të mbrojtjes dhe avancimit të barazisë nacionale, në pajtim me ligjin dhe statutin“.

Formulimi i tillë kushtëzon dy dilema:

1. termi në pajtim me ligjin mund të kuptohet në kuptim më të ngushtë dhe mund të na përshkruaj vetëm në Ligjin për vetqeverisjen lokale por edhe në kuptim më të gjerë në termin e përgjithshëm kushtetuto-ligjor.

2. fakti që fushëveprimi i punës është caktuar me ligj, por edhe që iu është besuar kuvendit të komunës vetëm e përbën procedurën e caktuar me statut, e cila sipas rregullave duhet të jetë në pajtim me ligjin, por edhe me interpretimin që me alinenë 8. hap mundësi të ndryshimit të mënyrës së punës që është paraparë me ligj dhe me statut.

Një konkludim i tillë nuk është i pa bazë sepse çështja e mënyrës së punës së ndonjë trupi nuk është „vetëm“ çështje e procedurës, nëse dihet se me procedurë mund të bllokohet dhe të asgjësohet puna e çfarëdo trupi ose organi.

Duket se këtë iniciativë duhet zgjidhur me interpretim zyrtar të organit kompetent shtetëror, e deri atëherë fushëveprimi i punës të caktohet me vendimin e kuvendit të komunës.

Kompetencat themelore të definuara me ligj janë që:

- ❑ „për qëndrimet dhe propozimet e veta të njoftojnë kuvendin e komunës, e cila është e obliguar që për ato të sqarohet në mbledhjen e ardhshme, e më së largu në afat prej 30 ditëve“,
- ❑ „përpara Gjyqit kushtetues të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutësisë dhe legjislacionit të vendimit ose ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës nëse mendon se me këtë në mënyrë direkte janë thyer të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike të përfaqësuara në këshillin për marrëdhënie ndërnacionale dhe të drejtën që nën kushtet e njehta para Gjyqit kushtetues të fillojë procedurën për vlerësimin e pëlqimit të vendimit ose ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës me statutin e komunës.

Me vendimin e komunës mund të përcaktohen edhe kompetenca të tjera të këshillit, por në këtë rast duhet patur kujdes që

me ato mos të merren kompetencat e trupave tjerë punues të kuvendit të komunës ose organeve tjera ekzekutive dhe të tjera të komunës.

KOMUNAT MULTIETNIKE NË SERBI

Në bazë të kriteriumeve nga neni 63. i Ligjit për vetqeverisje lokale në Serbi ka 68 komuna multietnike, nga të cilat 41 gjenden në Vojvodinë kurse 27 në Serbinë qendrore.

Komunat në Vojvodinë të cilat sipas Ligjit për vetqeverisjen lokale përmbushin kushtet për themelimin e këshilleve për mrrëdhënie ndërnacionale

KOMUNAT	GJITHSEJT BANORË	GJITHSEJT BANORË TË PAKICAVE NACIONALE	%
Ada	18.994	15.297	80,54
Alibunar	22.954	8.711	37,95
Apatin	32.813	10.384	31,65
Bac	16.268	7.743	47,60
Backa Palanka	60.966	10.703	17,56
Backa Topola	38.245	24.912	65,14
Backi Petrovac	14.681	10.412	70,92
Becej	40.987	22.423	54,71
Bela Crkva	20.367	3.652	17,93
Beoçn	16.086	4.230	26,30
Çoka	13.832	8.091	58,49

KOMUNAT	GJITHSEJT BANORË	GJITHSEJT BANORË TË PAKICAVE NACIONALE	%
Inxhia	49.609	5.211	10,50
Irig	12.329	1.670	13,55
Kanjizha	27.510	24.964	90,75
Kikinda	67.002	12.792	19,09
Kovaçica	27.890	17.775	63,73
Kovin	36.802	7.098	19,29
Kula	48.353	13.325	27,61
Mali Igjosh	13.494	8.008	59,34
Nova Crnja	12.705	3.478	27,38
Novi Becej	26.924	7.119	26,44
Novi Knezhevac	12.975	4.884	37,64
Novi Sad – grad	299.294	48.366	16,16
Oxhaci	35.582	4.455	12,52
Paņeva	127.162	22.279	17,52
Plandishte	13.377	5.406	40,41
Seçanj	16.377	4.050	24,73
Senta	25.568	21.895	85,63
Shid	38.973	7.210	18,50
Sombor	97.263	30.140	30,99
Srbobran	17.855	5.127	28,71
Sremski Karlovci	8.839	1.422	16,09
Stara Pazova	67.576	10.075	14,91

KOMUNAT	GJITHSEJTBANORË	GJITHSEJTBANORË TËPAKICAVE NACIONALE	%
Subotica	148.401	102.330	68,96
Temerin	28.275	9.284	32,83
Titel	17.050	1.883	11,04
Vrbas	45.852	10.025	21,86
Vrshac	54.369	12.337	22,69
Zhabalj	27.513	3.153	11,46
Zhitishte	20.399	7.038	34,50
Zrenjanin	132.051	26.168	19,82

* Janë përfshirë këto bashkësi nacionale: Jugosllavët, Shqiptarët, Boshnjakët, Bullgarët, Bunjevcasit, Vllasët, Goranët, Hungarezët, Maqedonët, Muslimanët, Gjermanët, Romët, Rumunët, Rusët, Rusinët, Sllovakët, Slloventë, Ukrainasit, Kroatët dhe Cekët.

Burimi: Qendra pr hulumtimin e etniciteteve, hulumtim dhe menaxhim në komunat multietnike, 2004–2005.

Komunat në Serbinë qendrore në të cilat sipas Ligjit për vetqeverisje lokale janë plotësuar kushtet për themelimin e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale.

KOMUNAT	GJITHSEJTBANORË	GJITHSEJTBANORË TËPAKICAVE NACIONALE	%
Babushnica	15.734	1.219	7,75
Bela Palanka	14.381	1.272	8,85

KOMUNAT	GJITHSEJT BANORË	GJITHSEJT BANORË TË PAKICAVE NACIONALE	%
Bojnik	13.118	1.391	10,60
Boljevac	15.849	4.663	29,42
Bor	55.817	12.758	22,86
Bosilegrad	9.931	7.378	74,29
Bujanovac	43.302	27.656	63,87
Dimitrovgrad	11.748	6.433	54,76
Doljevac	19.561	1.106	5,65
Golubac	9.913	1.051	10,60
Koceljeva	15.636	875	5,60
Kučevo	18.808	5.476	29,12
Majdanpek	23.703	3.145	13,27
Medvegja	10.760	2.951	27,43
Negotin	43.418	3.877	8,93
Nova Varosh	19.982	1.680	8,41
Novi Pazar	85.996	67.612	78,62
Petrovac	34.511	4.324	12,53
Presheva	34.904	31.487	90,21
Priboj	30.377	7.187	23,66
Prijepolje	41.188	17.221	41,81
Sjenica	27.970	21.232	75,91
Surdulica	22.190	3.306	14,90
Tutin	30.054	28.605	95,18

KOMUNAT	GJITHSEJT BANORË	GJITHSEJT BANORË TË PAKICAVE NACIONALE	%
Vranje	87.288	5.436	6,23
Zhagubica	14.823	3.378	22,79
Zhitoragja	18.207	1.171	6,43

* Janë përfshirë këto bashkësi nacionale: Jugosllavët, Shqiptarët, Boshnjakët, Bullgarët, Bunjevcët, Vllasët, Goranët, Hungarezët, Maqedonët, Muslimanët, Gjermanët, Romët, Rumunët, Rusët, Rusinët, Sllovakët, Sloventë, Ukrainët, Kroatët dhe Cekët.

Burimi: Qendra për hulumtimin e etniciteteve, hulumtim: Menaxhim në komunat multietnike, 2004–2005.

3

Këshilli

për marrëdhënie
ndërnacionale në komunat
multietnike

KOMUNAT NË TË CILAT JANË
THEMELUAR KËSHILLET PËR
MARRËDHËNIE NDËRNACIONALE

Sipas të dhënave të cilat deri në fillim të Dhjetorit të vitit 2005 i kanë grumbulluar Konferenca e përhershme e komunave dhe qyeteteve dhe Qendra për hulumtimin e etniciteteve, këshillet për marrëdhënie ndërnacionale janë themeluar në 16 komuna të Vojvodinës dhe dy në Serbinë qendrore dhe janë emëruar anëtarët e këshillit në këto komuna.

**Komunat në Vojvodinë në të cilat janë themeluar këshillet
për marrëdhënie ndërnacionale**

Ada
Apatin

Beçej
Kovaçica
Kovin
Novi Beçej
Novi Sad
Oxhaci
Plandishte
Subotica
Temerin
Vrshac
Zhabalj
Zhitishte
Zrenjanin
Novi Knezhevac

Në punën e 16 këshilleve të emëruara për marrëdhënie ndërnacionale në Vojvodinë marrin pjesë përfaqësuesit e bashkësive malazeze, bunjevace, kroate, maqedone, hungareze, rumune, romë, sllovaqe dhe serbe.

Në komunat Baç, Baçka Pallankë, Baçka Topollë, Bella Crkva, Irig, Kanjizhë, Kulla, Nova Crnja, Pancevë, Sremski Karlovci, Mitrovicë e Sremit, Stara Pazova,

Secanj, Senta, Srbobran, Titel dhe Vrbas me statut është paraparë të formohen këshille për marrëdhënie ndërnacionale, por këto trupa deri më tani nuk janë themeluar.

Komunat në Serbinë qendrore në të cilat janë themeluar këshillet për marrëdhënie ndërnacionale.

Prijepolje
Priboj

Në territorin e Serbisë, në bazë të nenit 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale ka 27 komuna multietnike, e bashkësitë nacionale, përfaqësuesit e të cilëve do të duhej të jenë të përfaqësuar në këshillet komunale për marrëdhënie ndërnacionale janë Shqiptarët, Boshnjakët, Bullgarët, Malazezët, Muslimanët, Romët, Serbët, Vllasët dhe Jugosllavët të cilët janë mbi 2% të popullatës të përfaqësuar në komunat Bosilegrad dhe Dimitrovgrad kryesisht të banuara nga pakica nacionale bullgare.

Komunat Aleksandrovç, Bujanoc, Bosilegrad, Dimitrovgrad, Kralevë, Leskoc, Malo Crnishte dhe Nova Varosh gjithashtu me statut kanë paraparë themelimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale, por deri më tani nuk kanë marrë ndonjë vendim për formimin dhe emërimin ose zgjedhjen e anëtarëve të këshillit. Është interesante se komunat Leskoc (me 156.252 banorë, 6.989 janë Romë, respektivisht 4,47%) Kralevë (nga 121.707 banorë, vetëm 867 janë Romë ose 0,72% nga numri i përgjithshëm i popullatës nuk janë Serb), Malo Crnishe (gjithsejt 13.853 banorë në mesin e të cilëve 401 respektivisht 2,89% janë Vllah dhe 194 ose 1,40% janë Romë) dhe Aleksandrovci në të cilën janë 98,79% popullatë serbe të cilat sipas Ligjit për vetqeverisjen lokale nuk janë multietnike, me statut kanë paraparë themelim të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale.

THEMELIMI I KËSHILLIT DHE ZGJEDHJA E ANËTARËVE

Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale themelohet në komunitet me përbërje nacionale të përziera të popullatës sipas kushteve që janë paraparë në nenin 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale (shih; Kapitullin 2).

Procedura e themelimit të këshillit

Procedura e themelimit të këshillit komunal për marrëdhënie ndërnacionale iu është lënë kuvendit të komunës. Veprimi i procedurës fillon me vërtetimin në statutin e komunës multietnike, obligimet e caktuara me ligj të arsimit të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale, kryhet me marrjen e vendimit të kuvendit të komunës për arsimimin e këshillit dhe emërimin e anëtarëve. Në ndërkohë zhvillohet procedura në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të këtij trupi.

❖ Rrjedha e procedurës:

1. Definimi i këshillit në statutin e komunës.
2. Iniciativa për themelimin e këshillit.
3. Propozimi i anëtarëve dhe konsultimi në lidhje me kandidatët e propozuar.
4. Vendimi i kuvendit të komunës për fushëveprimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së këshillit për marrëdhënie ndërnacionale.
5. vendimi i kuvendit të komunës për arsimimin e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale dhe emërimin e anëtarëve.

Sips procedurës së shkruar këshillin e ka arsimuar shumica e komunave. Statutet e komunave më së shpeshti përmbajnë një nen me të cilin parashihet themelimi i këshillit, e të gjitha vendimet tjera dhe obligimet në lidhje me këtë iu lihen kuvendit të komunës.

Pas kësaj pason një zbrazëti e caktuar në procedurë sepse me ligj nuk është paraparë, e në statut nuk është rregull të caktohet se kush do të fillojë procedurën për themelimin e këshillit, respektivisht kush e fillon procedurën e kandidimit të anëtarëve të këshillit.

Kjo është e dukshme edhe në faktin se këshillet janë themeluar në gjithsej 18 nga 68 komuna multietnike në Serbi të cilat duhet ta konstituojnë.

Gjithashtu, periudhë e gjatë në mes të përcaktimit të obligimeve statutare të komunës të themelojë këshill dhe marrja e vendimit të kuvendit të komunës për këtë, flet në favor të qëndrimit se kjo çështje duhet sqaruar.

Në shumicën e komunave të cilat e kanë konstituuar këshillin iniciativën e ka filluar kuvendi i komunës.

Pas fazës iniciative vijon proçesi i propozimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit. Në lidhje me këtë pjesë të procedurës janë vënë re përvoja të ndryshme të nëjsive të vetqeverisjes lokale.

Parim i përgjithshëm për atë se në këshill duhet të jenë të përfaqësuar përfaqësuesit e të gjitha bashkësive nacionale dhe etnike të cilët në popullatën e përgjithshme të komunës kanë 1% kryesisht respektohet, por pasi që nuk ka udhëzime në lidhje me propozimin e kandidatëve, lajmërohen mosmarrëveshje dhe parregullsi të caktuara.²

2 Shembujt: të shihen statutet e komunave: Ada (S.l. nr. 22/2004); Becej (S.l. nr. 3/2002); Apatin (2002); Zhabal (S.l. nr. 6/2002); Zrenjanin (S.l. nr. 3/2002); Zhiti {te (S.l. nr. 4/2005); Kovacicq (S.l. nr. 5/2002); Suboticë (S.l. nr.19/2002), Novi Sad (S.l. nr. 11/2002); Plandishte (31. maj 2002), Temerin (S.l. nr. 4/2002).

Praktika e njësive të vetqeverisjes lokale

Propozimi dhe zgjedhja anëtarëve të këshillit nga radha e pakicave nacionale

- Në disa komuna, në rastin e kandidatëve nga radhët e pakicave nacionale propozuesit janë këshillet nacionale të pakicave nacionale (shih Shtojcën 2, fq. 71). Në komunat Apatin, Kovaçicë, Zrenjanin dhe Zhabalj këshillet nacionale të pakicave nacionale drejtpërsëdrejti i kanë propozuar anëtarët e këshillit.
- Në komunën Novi Beçej iniciativa për themelimin e këshillit dhe propozimin e anëtarëve të këshillit është rregulluar me Vendimin mbi themelimin e këshillit, i cili është arritur në takimin e KK nga 29 Marsi i vitit 2005. Në këtë dokument me radhë janë përmendur bashkësitë të cilat në komunë marrin pjesë me më shumë se 1% të popullatës, e me këtë rast është precizuar që çdo bashkësi e cila e përmbush këtë kusht është e përfaqësuar në këshill me dy anëtarë. Me aktin e njejtë është e paraparë që kuvendi i komunës të fillojë iniciativën e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe atë që të drejtën e propozimit kanë grupet e qytetarëve, respektivisht 10 anëtarë të bashkësisë së caktuar; këshilltarët në kuvendin e komunës mund të propozojnë kandidatin e bashkësisë të cilës i takojnë, dhe më në fund shoqata e regjistruar për ruajtjen e veçorive nacionale, etnike, kulturore dhe të tjera të bashkësisë. Me propozimin është e duhur që të dorëzohen edhe të dhënat personale të kandidatit dhe deklaratë me shkrim të kandidatit për përkatësinë nacionale dhe dëshmi që propozimin është bërë nga propozuesit e autorizuar.

- Veçori tjetër në lidhje me propozimin e kandidatëve për anëtarë të këshillit nga radhët e pakicave nacionale hasim në Vendimin për fushëveprimin, përbërjen dhe mëyrën e punës së këshillit për marrëdhënie ndërnacionale të komunës Pllandishte, sipas së cilës në këshill janë përfaqësuar përfaqësuesit e pakicave nacionale të cilat janë të vendosura në komunë: Hungarezët, Rumunët, Sllovakët, Maqedonët dhe Romët. Këshilli ka 10 anëtarë, e anëtarët zgjedhen në bazë të propozimit të shoqatës së pakicave të përfaqësuar në këshillin komunal ose në bashkësitë lokale në të cilat pakicat nacionale dhe bashkësitë etnike përbëjnë më shumë se 50% të popullatës së përgjithshme të vendbanimit.

Përkundër procedurës së formalizuar dhe të menduar mirë për propozimin e kandidatëve nga radhët e pakicave nacionale në komunat Beçej, Plandishte, janë marrë vendimet në shumicën e komunave në të cilat kjo pjesë e procesit të arsimimit të këshillit zhvillohet në mënyrë të ndryshme— ndonjëherë në bazë të procedurës jo mjaft të qartë.³

- Në këtë kuptim, duhet të vihet në dukje procedura e propozimit të antarëve të këshillit nga radha e mino-

3 Në përbërjen e këshillit në komunën e Pllandishtes nuk ka përfaqësues të bashkësisë serbe. Duke pasur parasysh që bashkësia serbe në Pllandishte ka më shumë se 60% të banorëve si dhe natyrën e punës së këshillit për marrëdhënie ndërnacionale nuk ekzistojnë arsye shoqërore dhe juridike të arsyetuara që përfaqësuesit e kësaj bashkësie nuk janë të përfaqësuar në punën e këtij këshilli. Nga ana tjetër, pasi që shumicën absolute në KK Pllandishte, e cila i ka marrë të gjitha vendimet e përmendura, e përbëjnë këshilltarët e partive „shumicë“ politike, është e mundur që të jetë fjala për atë që ato nuk kanë dashur të marrin pjesë në punën e këtij trupi. Prapë, duket se është fjala për mosshqyrtimin e mjaftueshëm të organeve kompetente me rastin e formimit të këshillit, e jo për ndonjë qëllim të keq

riteteve nacionale në qytetin Novi Sad. Domethënë, sipas Vendimit të fushëveprimit, përbërjes dhe mënyrës të punës së këshillit për marrëdhënie ndëretnike të qytetit Novi Sad, i cili është aprovuar më 9. tetor, të vitit 2005,⁴ është paraparë që anëtarët e këshillit, pjesëtarë të minoriteteve nacionale, të zgjedhen edhe nga radhët e qytetarëve të shquar të komuniteteve nacionale dhe etnike, me propozim të komuniteteve nacionale të tyre dhe me anë të konsultimeve me përfaqësuesit e organizatave të komuniteteve nacionale dhe etnike të cilat veprojnë në qytet. Mënyra me të cilën është formuluar e drejta për propozimin e kandidatëve në qytetin Novi Sad, len mundësinë për bllokimin e themelimit të këtij trupi dhe opstrukcionin potencial të punës së tij të mëvonshme. Në praktikë kjo mund të duket ashtu sikur kandidatët i propozojnë shumë nga organizatat e minoriteteve, grupet e qytetarëve, kandidatët e pavarur, e pas konsultimit me organizatat e minoriteteve të cilat veprojnë në qytet, sipas kriteriumeve jo mjaft të qarta, selektohen dhe propozohen për zgjedhje kandidatët të cilët nuk kanë ndikim të dobishëm në vendimet e mëvonshme.

- Situata e ngjajshme është vërejtur edhe në komunën Zhitishte, në të cilën gjatë propozimit të kandidatëve nga radha e komuniteteve të minoriteteve nacionale të Hungarezëve, Sllovakëve, Rumunëve dhe Romëve nuk janë konsultuar këshillët e tyre nacionale, por është organizuar diskutimi publik në të cilin nuk kanë marr pjesë përfaqësuesit e partive politike opozitare dhe shumica e votuesve të tyre.⁵

4 „Gazeta zyrtare e qytetit Novi Sad“, viti XXII – numri 11, 24. qershor 2002.

5 Kompetent në komunën Zhitishte këtë problem kanë provuar t’ja tejkalojnë me vendimin joformal, që në mbledhjet e këshillit të ftohen

Në raste kur gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillit nga radha e minoriteteve nacionale nuk konsultohen këshillet nacionale të tyre, e megjithatë nuk janë përcaktuar kriteret e qarta sipas të cilëve zgjidhen anëtarët e këshillit, legjitimiteti i zgjedhjeve është dëmtuar seriozisht.

- Llojlojshmërisë së kandidimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të këshilleve komunale për marrëdhënie ndëretnike i ndihmon vendimi⁶ për themelimin e këtij trupi në komunën Oxhaci, sipas të cilit këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë prej të cilëve kryetari dhe dy anëtarë zgjedhen nga radha e këshilltarëve të Kuvendit Komunal, kurse katër nga radha e komuniteteve serbe, hungareze, sllovaqe dhe rome. Propozimin e vendimit për emërimin e anëtarëve të këshillit e përgatit Komisioni për çështje kadrovike, administrative dhe mardhënie pune të KK, me vetëiniciativë ose me propozimin e këshilleve të komuniteteve lokale ose shoqatave të cilat përfaqësojnë komunitetet nacionale, respektivisht ato etnike.

Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillit nga radhat e komuniteteve nacionale dhe etnike, është udhëhequr me ndihmën e kriteriumeve të ndryshëm në pikëpamje të konfirmimit të asaj se çka paraqesin komunitete nacionale, e çka ato etnike. Domethënë, deri sa të gjitha komunitet janë të definuara si nacionale, ajo rome është definuar si komunitet etnik. Sipas Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të minoriteteve nacionale, kjo mënyrë e qasjes është tejkaluar për arsye se me atë pjesëtarëve të komunitetit rom i është pranuar statusi i minoritetit nacional me të gjitha të drejtat të cilat rjedhin nga Ligji.

përfaqësuesit e këshillave nacionale të minoriteteve nacionale të cilat banojnë në komunë.

6 KK Oxhaci, nr. 011-1/2005-1 nga 31. janari 2005.

- Në mbledhjen e 17-të të Kuvendit të komunës së Suboticës, të mbajtur më 18. nëntor të vitit 2005, është marrë Vendimi për fushëveprimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së këshillit për marrëdhënie ndëretnike, sipas të cilit ky trup është formuar në pajtim me përbërjen nacionale të popullsisë së komunës, ashtu që në këshillin i cili përbëhet nga nëntë anëtarë janë përfaqësuar katër pjesëtarë të komunitetit hungarez, dy pjesëtar të serbëve dhe nga një pjesëtar kroat, malazez dhe të bunjevci. Duke marrë parasysh se në komunë, sipas regjistrimit të fundit jetojnë 0,97% banorë rom, në punën e këshillit, por pa drejtë të vendimmarrjes, është përfshirë edhe përfaqësuesi i këtij komuniteti.

Anëtarët e këshillit zgjedhen nga radhët e këshilltarëve, dhe i emëron Kuvendi Komunal me propozim të kryetarit të komunës, i cili domosdo, në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të këshillit nga radhat e minoriteteve nacionale, konsultohet me këshillet e tyre nacionale.

Megjithëse, anëtarët e këshillit në komunën e Suboticës zgjedhen nga radhat e këshilltarëve mbetet e hapur çështja në lidhje me mekanizmin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit nga komunitetet të cilat eventualisht nuk fitojnë vendet për këshilltarë në kuadër të Kuvendit Komunal.

Komunat Ovhaci dhe Subotica janë shembuj të komunave të cilat gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kanë përshtatur kriteriumin etnik me kriteriumin e përkatshmërisë të ndonjë partie politike të caktuar. Por, në disa komuna në Temerin, Novi Sad, Novi Knezhevac, Zhitishte partitë politike kanë pasur, megjithëse ndikimin indirekt, por edhe të rëndësishëm në propozimin dhe zgjedhjen e kandidatëve.

Propozimi dhe zgjedhja e anëtarëve të këshillit nga komuniteti nacional Serb

Duket se sfidë më të madhe paraqet propozimi i zgjedhjes së anëtarëve të këshillit të cilët e përfaqësojnë komunitetin nacional serb. Domethënë, Serbët e përbëjnë shumicën e popullsisë në 55 komuna militietnike, kurse në një numër të konsiderueshëm e përbëjnë popullsinë në 13 komuna, në të cilat pjesëtarët e minoriteteve nacionale kanë shumicën absolute të popullsisë. Vetëm ky fakt tregon se pjesëtarët e komunitetit serb për shkak të statusit të tyre të shumicës janë më përgjegjës për gjendjen dhe stabilitetin e marrëdhënieve ndëretnike. Për këtë arsye zgjedhja e anëtarëve nga nacionaliteti serb në këshillet komunale ka rëndësi të veçantë. Megjithëse, pasi që edhe rreth kësaj çështjeje nuk ekziston udhëzimi gjeneral, komunat kanë zhvilluar praktika të ndryshme.

- Në komunën Zhabalj përfaqësuesit e nacionalitetit serb i propozon kisha ortodokse Serbe, respektivisht famulli i sajë në këtë komunë. Rreth kësaj duhet të tërhiqet vërejtja në atë që kisha ortodokse Serbe është vetëm një nga propozuesit e mundshëm. Në pajtim me sistemin kushtetues-ligjor të vendit të gjitha kishat dhe komunitetet fetare janë të vendosura në fushën e shoqërisë civile dhe në kuptimin formal janë të barabarta me organizatat joqeveritare, shoqatat kulturore dhe organizatat tjera të cilat veprojnë në vetqeverisjet lokale. Megjithëse, ndikimi real i institucioneve tradicionale, siç është KOS, është shumë më i madh nga ndikimi të cilin e kanë shumica e organizatave tjera civile. Në këtë kuptim, janë të arsyeshme pritjet e vetëqeverisjeve lokale se legjitimiteti i anëtarëve të këshillit të cilët i propozon ky institucion, respektivisht këshilli i kishës komunale i KOS, do të jenë

të themeluar mbi mirëbesimin të cilin e gëzojnë në kuadër të këtij institucioni.

Problemi mund të paraqitet nëse vetëqeverisjet lokale kërkojnë edhe prej kishave dhe komuniteteve fetare të propozojnë anëtarët e tyre në këshille. Në këtë rast do të humbet kuptimi primar i themelimit të këshillit, dhe integritet e tij me siguri do të lëviznin nga shqyrtimet e çështjeve ndëretnike, në drejtim të marrëdhënieve dhe problemeve ndër-fetare.

- ❑ Në komunën e Zrenjaninit, anëtarin e këshillit nga radhat e komunitetit serb, por edhe nga komunitetet e minoriteteve të cilat nuk i kanë të zgjedhur këshillet nacionale, e propozon dhe emëron Komisioni për çështje kadrovike, administrative dhe marrëdhënie të punës së kuvendit komunal.
- ❑ Është thënë se në qytetin Novi Sad nuk është zgjidhur në mënyrë të duhur zgjedhja e anëtarëve të këshillit nga radhat e minoriteteve nacionale. Ngjashëm është edhe sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të këshillit të cilët përfaqësojnë komunitetin serb. Domethënë, pesë, nga gjithësejt nëntë anëtarë të këshillit janë të nacionalitetit serb dhe zgjidhen, me gjasa, nga radhat e partive politike të përfshira në kuvendin e qytetit. Ky lloj i zgjedhjes dhe përbërjes së këshillit, i cili është i njejtë me atë të komunës së Zhitishtës dhe Prijepoles, hap rrugën e mazhorimit të komuniteteve të minoriteteve nacionale.
- ❑ Në komunën Apatin, me Vendimin e themelimit të këshillit, të cilin e kanë aprovuar këshilltarët⁷ është paraparë që anëtarët e këshillit të zgjedhen sipas përkatësisë etnike të qytetarëve, që propozuesit të anëtarëve që zgjedhen të jenë nga radhat e pjesëtarëve të minoriteteve etnike, këshillat

7 „Gazeta zyrtare KK Apatin“, nr. 8, nga 23. maji 2005.

nacionale të minoriteteve nacionale të cilët përbejnë më shumë se 1% të popullsisë së komunës, kurse për përfaqësuesit e komunitetit serb qytetarët me preardhje serbe. Me vendimin, nga data 3. Tetor të të njejtit vit, janë emëruar për anëtarë të këshillit nga dy përfaqësues të komunitetit serb, hungareze dhe kroate, dhe nga një përfaqësues i komunitetit rumun dhe rom.⁸

Pjesëmarrja e qytetarëve në punën e këshillit

Komuna e vetme, e cila gjatë propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, principin etnik dhe interesin e partive politike të përfaqësuara në kuvendin komunal iu ka nënshtruar principit qytetruës është komuna Ada. Neni 63. i Statutit të komunës së Adës⁹ parashikon formimin e këshillit për marrëdhënie ndëretnike në punën e të cilit marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve nacionale dhe etnike në komunë. Por, me nenin 65. të Statutit të KK të Adës është caktuar që fushëveprimi, përbërja, mënyra e punës dhe zgjedhja e anëtarëve të këshillit përcaktohet me vendimin e veçantë të kuvendit komunal. Ky vendim¹⁰ është aprovuar tre vjet më vonë, më 21. Prill të vitit 2005, dhe me atë janë paraparë përgjëgjësitë nga statuti i kuvendit komunal, respektivisht Ligjit për vetëqeverisje lokale. Pjesa e tretë e këtij vendimi i referohet zgjedhjes së antarëve të këshillit, në kuptim se, në punën e këtij trupi përveç këshilltarëve mund të përfaqësohen edhe qytetarët, por kryesuesi duhet të jetë këshilltar, ashtu që në mënyrë efikase të përfaqësojë qëndrimet e këtij trupi punues

8 „Gazeta zyrtare KK Apatin“, nr. 11, nga 3. tetori 2005.

9 „Gazeta zyrtare e komunës Ada“, nr. 22/2004.

10 Vendimi për fushëveprimin, përbërjen dhe mënyrës së punës të këshillit për mardhënie ndëretnike, KK Ada, nr. 02-23/2005-01, nga 21. prilli 2005.

kontinuel të kuvendit komunal para këshilltarëve dhe organeve tjera komunale.

Më në fund, vendimit të përmendur i ka paraprirë Vendimi për themelimin e këshillit për mardhënie ndëretnike në bazë të cilit mund të vihet re se në punën e këtij trupi marrin pjesë qytetarët, e jo përfaqësuesit e komuniteteve nacionale. Meqenëse është qartë se në punën e këtij trupi marrin pjesë më tepër nacionalitete, Serbët, Hungarezët, Romët, kriteriumi vendimtar për zgjedhjen e tyre nuk ka qenë përkatësia nacionale apo etnike, por statusi i këshilltarit ose propozimi i qytetarëve sipas të cilëve kanë marrë mandatin që në periudhën katër vjeçare të përfaqësojnë interesat e tyre në këtë trup.

Dilemat e njësisë të vetëqeverisjes lokale në lidhje me themelimin e këshillit dhe zgjedhjen e anëtarëve

Kush janë „shfrytëzuesit“ e nenit 63?

Në nenin 63. të Ligjit për vetëqeverisje lokale veçanërisht precizohet që këshillet themelohen për shkak të barazisë së komuniteteve nacionale në komunat multietnike. Duke marrë parasysh se me nenin e njejtë janë përcaktuar kriteriumet sipas të cilëve një komunë konsiderohet multietnike (më shumë se 5% të pjesëtarëve të një bashkësie ose më shumë se 10% të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve në numrin e përgjithshëm të qytetarëve të komunës sipas regjistrimit të fundit të banorëve) është qartë që shfrytëzuesit e ligjit janë komunitete nacionale (etnike) të cilat në komunë paraqesin pakicën numerike. Në këtë kuptim Ligji nuk ka bërë dallim mes pjesëtarit të komunitetit serb, malazez dhe pjesëtarit të minoriteteve nacionale.

Megjithatë, nëse pranojmë interpretimin që titularët e drejtësisë në nenin 63. janë komunitetet nacionale, arrijmë në një

situatë të komplikuar me të cilën në çdo komunë në të cilën një nga komunitetet nacionale, domethënë, nëse jo ndonjë tjetër, atëherë ajo serbe, përbën 5% të popullsisë së komunës, kurse edhe një komunitet (pakica) edhe 1%, do të duhej në pajtim me Ligjin të themelohet këshilli për marrëdhënie ndëretnike.

Nga ana tjetër, hutueshmërinë e krijon praktika e vetëqeverisjeve lokale dhe këshilleve komunale për marrëdhënie ndëretnike, të cilat fueshëveprimin e punës së tyre më së shpeshti e koncentrojnë në problemet e minoriteteve nacionale. Duke marrë parasysh strukturën etnike të pupullsisë së Serbisë, si dhe specifikat e saj regjionale dhe lokale, dhe problemet me të cilat ballafaqohen komunat në lidhje me pozitën e minoriteteve nacionale dhe realizimin e të drejtave të tyre, fushveprimi real i punës së këshilleve komunale për marrëdhënie ndëretnike me arsye është drejtuar kah çështjet në lidhje me barazinë e pjesëtarëve të minoriteteve nacionale dhe komunitetet e tyre.

Në rrethanat ekzistuese shoqërore dhe juridike, dilemat do të mënjanoheshin nëse do të vinte deri tek korigjimi i nenit 63. të Ligjit për vetëqeverisje lokale në kuptim të përdorimit të termeve precize – komuniteti nacional serb dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Inspirimi dhe burimi për këtë ndryshim të nenit 63. duhet të ishte neni 55. i Kartës së të drejtave njerëzore, të minoriteteve dhe lirive qytetare, e cila parashikon që shtetet anëtare të bashkësisë Serbi dhe Mali i Zi janë „*të obligueshme që të marrin masa për përparimin e barazisë së plotë dhe efektive mes pjesëtarëve të minoriteteve nacionale dhe atyre që i takojnë shumicës, në të gjitha fushat e jetës ekonomike, politike dhe kulturore*“. Edhe përkundër se ky nen i referohet drejtë masave të veprimit afirmues, në mënyrë indirekte i referohet edhe të gjitha çështjeve tjera në të cilat një nga komunitetet pakicë për shkak të gjendjes shoqërore jo të barabartë duron dëmin e vërtetë.

Kush i propozon anëtarët e këshillit?

Më shpesh, në praktikë, propozuesit janë këshilltarët në kuvendet komunale, këshillet nacionale të minoriteteve nacionale, kisha ortodokse Serbe, grupet e qytetarëve, shoqatat kulturore të minoriteteve nacionale, organizatat joqeveritare.

Dilema kryesore në lidhje me këtë çështje është se kush duhet të iniciojë themelimin e këshillit dhe në këtë kuptim të kërkojë propozimin e kandidatëve dhe mendimin rreth tyre, nga institucionet e komuniteteve të cilat duhet t'i përfaqësojnë. Në këtë kuptim, me vendimet për themelimin e këshillit do të duhej të autorizohet një institucion në kuvendin komunal që të iniciojë themelimin e këshillit, si dhe procesin e formimit të këshillit.

Cilat komunitete janë të përfaqësuara në këshille?

Krahas dilemës në lidhje me të drejtën e propozuesve të anëtarëve të këshilleve komunale për marrëdhënie ndëretnike në disa komuna është prezent edhe problemi në lidhje me përfshirjen e komuniteteve nacionale në këto trupe. Domethënë, në një numër më të vogël të komunave mbretëron mendimi se anëtarët e këshillit duhet të jenë vetëm përfaqësuesit e minoriteteve nacionale, e jo edhe përfaqësuesit e komunitetit serb. Duket se ky mendim nuk përputhet me tendencën e ligjvënësist që të themelojë trupa në të cilat do të përfshiheshin përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve nacionale të cilat në komunat multietnike, të cilat e plotësojnë kriteriumin e shumës së paraparë me nenin 63. të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

KOMPETENCAT E KËSHILLIT

Kompetencat e këshillit mund të ndahen në:

- a) kompetencat themelore të cilat burojnë nga alinea 4. dhe 7. të nenit 63;
- b) kompetencat e defnuara me vendimet e kuvendit komunal.

Kompetencat themelore

Në lidhje me kompetencat themelore të cilat i referohen shqyrtimit të çështjeve të barazisë nacionale, duhet të përmendet që edhe ato i vërteton dhe në shtesë i defnion kuvendi komunal. Në kuadër të këtyre kompetencave këshilli jep mendimin për çdo propozim të kuvendit komunal i cili është në lidhje me barazinë nacionale, dhe ka të drejtë edhe të fillojë procesin para gjyqit kompetent nëse mendon se vendimi i kuvendit komunal është në kundërshtim me statutin e komunës.

Realizimi i këtyre kompetencave është në lidhje me dy çështje të hapura. E para është në lidhje me definimin e termit barazia nacionale, kurse e dyta me zhvillimin e mekanizmave në kuvendin komunal në lidhje me punën frytdhënëse të këshillit.

Në kuptimin e gjerë, barazia ndërnacionale realizohet në secilin segment të jetës shoqërore: segmentin e edukimit, punësim, informim, ekonomi, marrëdhëniet sociale si edhe në çështjet e planit hapsinor të komunës dhe rregullimin e infrastrukturës.

Një interpretim i tillë i kërrij nocioni do të kërkonte që këshilli për marrëdhënie ndërnacionale të shqyrtojë një numër të madhë të propozimeve dhe vendimeve të kuvendit komunal.

Në kuptimin e ngushtë, nocioni i barazisë ndërnacionale, në kuptim të operacionalizimit të nenit 63 ka të bëjë me rastet kur kuvendi i komunës merr vendime në lidhje me realizimin e të drejtave të cilat kanë të bëjnë me të drejtat individuale dhe kolektive të përfaqësuesve të bashkësive nacionale edhe ate me: punësimin e barabartë në shërbimet publike, përdorimin e gjuhës

zyrtare të minoriteteve, rrjetin e institucioneve shkollore dhe parashkollore, emërimin e drejtorëve të institucioneve publike, përfaqësinë e bashkësive në mjetet e informimit themelues i të cilit është kuvendi i komunës dhe të tjerë.

Problemi i mekanizmit të cilin duhet zhvilluar që puna e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale të jetë e frytshme ka të bëjë me dorëzimin e rregullt dhe me kohë të propozimeve të kuvendit komunal anëtarëve të këshillit.

Në praktikë, njësitë e vetëqeverisjes lokale i dorëzojnë materialet në mënyrë selektive dhe shpesh vonohen. Medjithate, duke marrë parasysh praktikën që këshillat jipen rrallë si dhe duke marrë parasysh faktin se deri në dhjetorë 2005 nuk ka pasë reagime të rëndësishme të këshillit ndaj vendimit të kuvendit komunal mund të konkludohet se këshillat nuk i orientojnë aktivitetet kah kompetencat e tyre elementare por mirren me aktivitetet e dorës së dytë.

Në ate kuptim, në disa komuna arsyeja për takim të këshillit dhe punën e tij kanë qenë konfliktet në mes të vendasve të nacionaliteteve të ndryshme. Edhe pse bëhet fjalë për punë të cilat janë nën kompetencat e policisë dhe organeve gjyqësore, anëtarët e këshillit tentojnë të regajojnë në periudhën post konfliktuoze.

Kompetencat e definuara me anë të vendimit të kuvendit komunal

Kompetencat të cilat vërtetojnë me anë të vendimit të kuvendit komunal janë më gjerësisht të paraqituara dhe shpesh ndeshen me kompetencat e trupave tjera punuese të kuvendit komunal.

Është karakteristik shembulli i vendimit mbi themelimin e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale në komunën Apatin me anë të së cilit është paraparë që qëllimet e punës së këtij trupi

kanë të bëjnë me: avancimin e punës së vetëqeverisjes lokale, tolerancën ndëretnike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ruajtjen e identitetit etnik dhe kulturorë të bashkësive, promovimin e multikulturalizmit, kultivimin e meritave qytetare dhe traditës së kohabitacionit, kundërshtimit të gjuhës së urrejtjes dhe ksenofobisë të të gjitha bashkësive nacionale dhe etnike si dhe zhvillimin e bashkëpunimit të qytetarëve, OJQ-ve me njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe kompetencat në lidhje me realizimin e barazisë nacionale në edukim, kulturë, organizimin shoqërorë, ekzekutimin e pushtetit administrativ dhe organizimin e shërbimeve, komunikimit publik, punësimit dhe mbrojtjes së monumenteve kulturore.

Me anë të vendimit është paraparë që për shkak të realizimit të kompetencave, këshilli për marrëdhënie ndërnacionale në komunën Apatin mund të ndër marrë masa në lidhje me parandalimin e tensioneve etnike dhe që në atë kuptim të organizojë dhe mbështesë masat të cilat kanë për qëllim mirëkuptim më të mirë të bashkësive nacionale dhe etnike si dhe realizimin e një atmosfere shoqërore të dobishme në komunë.

Përveç kësaj, këshilli ndërmerr dhe masat të cilat kanë të bëjnë me çështjet socio – ekonomike të bashkësive etnike. Në atë kuptim, parashihet si në vijim *„këshilli ndërmerr aktivitete të cilat kanë funksion të pjesëmarrjes së barabartë të të gjitha bashkësive nacionale dhe etnike në territorin e komunës në zhvillimin dhe përforcimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme“* si dhe *„këshilli vëmendje të veçantë i kushton punësimit të barabartë të të gjitha përfaqësuesve të bashkësive nacionale dhe etnike në territorin e komunës si dhe që mjetet për donacionin të parapara për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe aktiviteteve të tjera në fushën e ekonomisë dhe jetës shoqërore të jenë të disponueshme në mënyrë të barabartë përfaqësuesve të të gjitha bashkësive nacionale dhe etnike në territorin e komunës“¹¹.*

11 Član 13. Odluke o osnivanju saveta za međunacionalne odnose SO Apatin.

Pa dyshim se kompetencat e parapara kaq të zgjeruara kanë tejkaluar idenë e ligdhënësit mbi atë se këshillat për marrëdhënie ndërnacionale të mirren me realizimin e barazisë nacionale në komunë, respektivisht, të shqyrtojë dhe japë opinione mbi vendimet e kuvendit komunal në lidhje me pozitën e bashkësive nacionale dhe etnike dhe të inicojë mekanizma për mbrojtje ligjore në rast të thyerjes së të drejtave të tyre.

Në atë kuptim, do të kuptohej që ingerencat e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale, kur bëhet fjalë për barazinë nacionale të bashkësive me rastin e punësimit koncentrohen në përcjelljen e gjendjes në lidhje me punësimin e tyre të barabartë në shërbimet publike komunale. Vendimi i aprovuar në komunën e Apatinit, pa marrë parasysh që legjitimitetin mund ta dëshmojnë nga neni 55. Kartat mbi të drejtat e njeriut dhe minoriteteve dhe lirive të qytetarëve parashohin që kompetencat e këshillit të dalin nga kompetencat e parapara me Ligj dhe të harmonizohen me marrëdhëniet sociale në komunën multietnike.

Kuvendi komunal i Zrenjaninit me anë të Vendimit mbi këshillin për marrëdhënie ndërnacionale¹² ka definuar kompetencat elementare të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale dhe po ashtu ka paraparë që këshilli mund të shqyrtojë disa çështje nga fushëveprimi i vet, të edukojë grupin punues apo të angazhojë disa anëtarë që të studijojnë disa pyetje dhe të informojnë këshillin për atë.

Me anë të vendimit në fjalë është vërtetuar që këshilli bjen Rregulloren e punës e cila është aprovuar në takimin e këshillit më 29 qershor 2005.

Nga procesverbalet nga takimet e këshillit mund të konkludohet që këshilli, përveç çështjeve nga kompetenca e vet është marrë edhe me çështjet të cilat kanë të bëjnë me realizimin

12 „Službeni list opštine Zrenjanin“, br. 3/2005.

e të drejtave të minoriteteve nacionale – avancimi i informimit në gjuhët e minoriteteve nacionale, finansimi i shoqërive të tyre kulturore etj.

Praktika e vetëqeverisjeve lokale në lidhje me kompetencat

Në praktikën e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale të cilët janë themeluar në dhjetor të vitit 2005 numri më i madh i aktiviteteve ka pasë të bëjë me shqyrtimin e çështjeve në lidhje me pozitën e minoriteteve nacionale. Një gjendje e tillë është e kuptueshme duke marrë parasysh faktin që shteti nuk ka strategji të përshtatshme për integrimin e minoriteteve nacionale.

Karta mbi të drejtat e njeriut dhe minoriteteve dhe lirive të qytetarëve dhe Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale përfaqësojnë dokumentet të cilat në fillim të dekadës, zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave e kanë drejtuar kah principet demokratike por përshkak të paqartësisë së këtyre dokumenteve, karakterit deklarativ të Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, çështjeve të hapura politike dhe legale dhe papërputhshmërisë së shumicës së ligjeve me anë të së cilëve rregullohet pozita e pakicave nacionale me këto dokumente nuk kanë përfshirë masat në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave nacionale.

Në komunat e Vojvodinës situata është më e përshtatshme se sa në komunat në Serbinë qendrore. Për këtë flasin edhe të dhënat se deri në fund të vitit 2005 në Vojvodinë nga 44 komuna multietnike, këshilli për marrëdhënie ndërnacionale është themeluar në 16 komuna kurse në Serbinë qendrore vetëm në dy komuna të Sanxhakut.

Në praktikë në këto komuna shpesh lajmërohen probleme të realizimit të të drejtave të pakicave nacionale kurse sipas Ligjit mbi

vetqeverisjen lokale komunat janë drejtëpërdrejtë të angazhuara të kujdesen për realizimin e të drejtave individuale dhe kolektive të pakicave nacionale dhe veçanërisht për përdorimin e gjuhës së tyre dhe korrespondencave (shtojca 2. fq. 71).

Përveç kësaj duhet të theksohet se me kyçjen e këshilleve nacionale në procesin e kandidimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtëpërdrejtë në punën e këtyre trupave janë kyçur edhe çështjet e punës së këtyre institucioneve.

Kjo nënkuptohet duke marrë parasysh se këshillet nacionale kanë vështirësi të mëdha në lidhje me implementimin e politikës kulturore të pakicave në bashkësitë nacionale. Edhe pse me ligj janë vërtetuar mekanizmat për implementimin e të drejtave të pakicave në bashkësitë nacionale është paraqitur problemi me legjitimitetin e vetqeverisjeve të pakicave të cilët zgjedhen na nivelin nacional por jo edhe në atë lokal.

Dilemat në lidhje me kompetencat e këshilleve

Cilat janë kompetencat e këshilleve?

Nëse fjalë për fjalë do të aplikoheshin kompetencat e këshillave të definuara me nenin 63, të cilat janë në lidhje me shqyrtimin e vendimeve të kuvendeve komunale, që i referohen të drejtave të komuniteteve nacionale dhe lëvizjen e mekanizmave të mbrojtjes së interesave të tyre në komunë, atëherë, nuk do të duhej të ketë dilema në lidhje me punën e këtyre trupave. Megjithatë, duke marrë parasysh që fushëveprimin e punës së këshilleve e përcakton kuvendi komunal në përputhje me statutin e vet, është i mundshëm zgjerimi i kompetencave të këtij trupi.

Bazat për zgjerimin e kompetencave të këshillit duhet të jenë nevojat reale të qytetarëve dhe situata në komunë në lidhje me gjendjen e raporteve ndëretnike, por edhe neni 55. i përmendur.

Kartat për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, dhe të drejtave qytetare, të cilat janë në lidhje me sigurimin e barazisë efektive në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Kompetencat të dalura nga ky kuptim dhe bazamentit juridik, janë shumë më të gjëra nga ato të cilat i definojnë neni 63. të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Në raport me këtë është vështirë të përkufizohet se cilat çështje për të cilat kuvendet komunale marrin vendime nuk i referohen barazisë nacionale të qytetarëve. Këto çështje mund të jenë në lidhje me ndërtimin e infrastrukturës në vendet e banuara në të cilat jetojnë pjesëtarët e pakicave lokale ose në çështjet e realizimit të së drejtës për zhvillimin kontinuel të të gjitha pjesëve të komunës.

Përputhja e kompetencave

Në disa komuna, përveç asaj që kompetencat e këshillave për marrëdhënie ndëretnike përputhen me kompetencat e trupave tjerë punues të kuvendit komunal, vërehet që kompetencat e tyre përputhen me kompetencat e organeve ekzekutuese të komunës. E në komunat, në të cilat pjesëtarët e pakicave nacionale përbëjnë shumicën lokale, vërehet përputhja e kompetencave të këshillave për marrëdhënie ndëretnike me kompetencat e këshillave nacionale të pakicave nacionale të caktuara me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale.

Përputhja e kompetencave të këshillave me kompetencat e këshilleve nacionale të pakicave nacionale

Këshillet nacionale të pakicave nacionale janë institucionet vetëqeverisëse të pakicave të cilat pakicat nacionale i përfaqësojnë në lidhje me realizimin e të drejtave për autoniminë kulturore. Këto trupe zgjedhen në bazë të *Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale* dhe *Rregullores për mënyrën e punës së kuvendeve elektorale për zgjedhjen e këshilleve të pakicave nacionale*, të cilët i ka

aprovuar Ministri për komunitetet nacionale dhe etnike (Shtesa 2. faq. 71).

Këshillet nacionale të pakicave nacionale dhe këshillat komunale për marrëdhënie ndëretnike legjitimitetin e nxjerrin nga rrethet e ndryshme shoqërore e politike dhe kanë nivelin e ndryshëm të kompetencave në vetëqeverisjen lokale.

Dallimi kryesor është në atë se këshillet komunale të pakicave nacionale janë pjesë të njësisë së vetëqeverisjesë lokale, dhe direkt janë të lidhura me kuvendet komunale. Këshillet nacionale të minoriteteve nacionale, si institucione të vetëqeverisjeve minoritare, janë institucione të cilat përfaqësojnë interesat e minoriteteve para organeve të pushtetit në fushën e autonomisë kulturore.

Kur bëhet fjala për marrëdhëniet e këshillave nacionale të minoriteteve nacionale dhe vetëqeverisjeve lokale, duhet të përmendet që lidhja e tyre në mënyrë indirekte realizohet përmes këshilltarëve në kuvendet komunale, të cilët si funksioner komunal janë zgjedhur në këshillin e caktuar nacional.

Veçanërisht është me rëndësi të përmendet se vetëqeverisjet minoritare zgjidhen në nivelin nacional, dhe sipas ligjeve tona, për momentin, këto lloje të trupave nuk është e mundur të zgjedhet në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Në këtë kuptim, kurdo që mundet, në kuptimin formal-juridik, duhet të ndahen kompetencat e vetëqeverisjeve minoritare nga kompetencat në të cilat janë të ngarkuar këshillet komunale për marrëdhënie ndëretnike. Natyrisht, kjo nuk e çkyq bashkëpunimin e këtyre trupave në kuptim të kërkimit dhe dhënies së mednimit për çështje të ndryshme, marrjen e masave të përbashkëta dhe aktiviteteve, dhe të tjera. Megjithatë, përpunja e drejtëpërdrejtë e kompetencave do të binte deri te situata që minoritetet politikisht mirë të organizuara, të cilët kanë krijuar vetëqeverisjet e forta minoritare, kanë mundësinë që në mënyrë indirekte të krijojnë vetëqeverisjet minoritare komunale dhe kështu të ndikojnë në vendimet të

cilët janë në interes vetëm për pjesëtarët të minoriteteve në njësinë e caktuar të vetëqeverisjes lokale. Në këtë mënyrë, do të mundësohej që pjesëtarët e minoritetit të caktuar ose vetëm një pjesë e ndonjë minoriteti, të angazhohen për pozitën më të volitshme në raport me komunitetet tjera minoritare ose në raport me bashkëkombasit e tyre në komunat tjera.

Situata në lidhje me këtë mund të përparonte me ndryshimin e *Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të minoriteteve nacionale*, në kuptim të themelimit të vetëqeverisjeve minoritare komunale dhe zvogëlimin e ndikimit të partive politike në lidhje me kandidimin e anëtarëve të vetëqeverisjeve minoritare.

Përputhja e kompetencave të këshillit me kompetencat e organeve ekzekutive qeverisëse

Pasi që askund në veçanti nuk është thënë si zgjedhen anëtarët e këshillit për marrëdhënie ndëretnike, ekziston mundësia që në ato të emërohen dhe zgjedhen anëtarët e këshilleve komunale. Poashtu, ekziston mundësia që këshilli komunal një pjesë të administratës e organizon në mënyrë që të merret me pyetje të njejta me të cilat merret edhe këshilli për marrëdhënie ndëretnike. Në të dyja rastet nuk ekziston as konflikti i interesave, e as rrathanat tjera të caktuara me ligj, të cilat në mënyrë të prerë do ti ndalonin. Megjithatë, do të duhej t’iu shmanget ndikimit të pushtetit ekzekutiv në punën e këshillit dhe të respektojë autonominë e tyre.

Në lidhje me këtë problem ekziston edhe një dilemë e cila është vështirë të kuptohet. Pasi që, në Ligjin për vetëqeverisje lokale neni 63. sipas të cilit themelohen këshillet për marrëdhënie ndëretnike është vendosur alinea 4. e cila merret me definimin dhe organizimin e administratës komunale. Në këtë kuptim është i mundur interpretimi sipas të cilit këto trupe themelohen si shërbime profesionale në komunat. Në kundërshtim me këtë interpretim janë alinetë 4–6. të nenit 63. të cilat kompetencat

e këshillit për marrëdhënie ndëretnike i drejtojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë kah kuvendet komunale.

Në konstatimin që është më e drejtë të drejtohet puna e këshillit për marrëdhënie ndëretnike në kuvendet komunale na udhëzon edhe neni 34. të Ligjit për vetëqeverisje lokale, me të cilin është paraparë që kuvendi komunal sipas statutit të themelohë trupa punues të rregullt dhe të çrregullt, të cilat, para së gjithash, japin mendime në lidhje me propozimet e rregulloreve dhe vendimeve të cilat i marrin kuvendet komunale.

Në praktikën e njërive të vetëqeverisjeve lokale janë karakteristik shembujt në tri komuna, në të cilat zyrtarët komunal janë edhe anëtar të këshillave për marrëdhënie ndëretnike. Prezenca e tyre në punën e këtyre trupave mund të drejtojë vendimet e këshillit dhe kompetencat, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin dhe Statutin, në drejtim të interesave të administratës lokale ose interesave të komuniteteve të veçanta nacionale.

Në komunën e Beçejit, në bazë të statusit është themeluar këshilli për marrëdhënie ndërnacionale. Këshilli i parë është themeluar në vitin 2003, mirëpo është shpërndarë në vitin e ardhshëm, pas zgjedhjeve lokale, me vendimin mbi shkarkimin dhe emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale KK Beçej¹³, kurse me propozimin e partive politike që përfaqësohen në KK janë emëruar anëtarët e këshillit aktual në përbërje prej 6 anëtarëve. Në komunën në të cilën afërsisht banojnë 41% serb dhe 48% të nacionalitetit hungarez, këshilli mbledhjen e parë e ka mbajtur më 3 Nëntor të vitit 2005.

Mosaktiviteti i anëtarëve të këshillit sipas shumë gjasave është kushtëzuar nga vendimi i këshillit komunal që të angazhojë një nga anëtarët që të mirret me çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për bashkëpunim me bashkësitë religjioze.

13 SO Beçej, br. 021-19/05-1 od 1. 8jula 2005.

Aktivitetet e këtij neni të këshillit komunal kanë lënë në plan të dytë këshillin për marrëdhënie ndëretnike. Edhe pse sipas të gjitha gjasave bëhet fjalë për tentimin e këshillit komunal të avancojë efkasitetin e punës, duhet të kihet kujdes që aktivitetet nga pushteti egzekutues në....

Ne komunën Zhitishte, anetaret e keshillit për marrëdhënie ndërnacionale janë kryetari dhe sekretari i kuvendit komunal i cili kryeson punën e këtij trupi. Duke marrë parasysh që këshilli takimin e vet të fundit e ka mbajtur në fund të Tetorit të vitit 2005, mbetet të analizohet se si prezenca e personit të parë të kuvendit komunal dhe më të përgjegjshmit në administratën komunale do të ketë ndikim në punën dhe vendimet e këshillit.

Më më fund, komuna e Pribojit, në bazë të nenit 54 të statutit të komunës ka marrë vendimin për themelimin e Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale si dhe dekretin mbi emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit. Përderisa në vetë vendimin mbi themelimin nuk gjejmë dallime të rëndësishme në krahasim me nenin 63 të Ligjit për vetqeverisjen lokale dhe në praktikë, në lidhje me konstituimin e këtyre trupave në komunat e Vojvodinës. Dekreti mbi emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit përmban qasjen sipas së cilës komuna e Pribojit veçohet nga të tjerat. Njëherit, të gjithë anëtarët e këshillit të cilët i ka emëruar kuvendi komunal në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të këshillit komunal.

Sipas vendimit mbi themelimin, kryetari i këshillit është kryetari i komunës kurse sipas qasjes që anëtarët tjerë të emërohen nga ana e kuvendit komunal nuk është vërtetuar kush i propozon ata.

Në princip, është gjithëherë më mirë që anëtarët e këshillit të jenë kandidatë të pavarur, respektivisht, qytetarë të cilët i kanë propozuar shoqatat apo institucionet të cilat mirren me disa nga aspektet e problemit për të cilat këshilli është kompetent apo që ata të zgjedhen nga rradha e këshilltarëve të kuvendit komunal.

Kyçja e anëtarëve vetëm nga qeveria ekzekutuese në punën e këshillit mund të shkaktojë probleme të cilat do të paralizojnë punën e tyre të frytshme dhe marginalizuar ndikimin e qytetarëve për kompetencat e parapara me ligj të këtyre trupave.

Por, duke pasur parasysh që njësisia e vetqeverisjes lokale në Priboj në të cilën gjatë viteve të nëntëdhjeta marrëdhëniet ndërnacionale kanë qenë të acaruar, banorët e të cilit sigurisht ende janë të prekur me ndodhitë nga e kaluara e afërme, është e kuptueshme intenca e autoriteteve ekzekutuese, që çështjet e ndieshme që do të mund të prishnin bazën e luhatshme të ndërtimit të besimit ndëretnik i besojnë për vendosje një grupi të ngushtë të njerëzve.

Pason pyetja, sa është kjo mënyrë e vendosjes në pajtim me principet e decentralizimit të autoriteteve në vetqeverisjen lokale dhe a duhet të merren kryesisht autoritetet komunale me avancimin e marrëdhënieve ndërnacionale ose të gjitha segmentet e demokracisë lokale.

4

Propozime

në lidhje me themelimin dhe punën e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale

Nnga praktika e komunave të cilat e kanë formuar këshillin për marrëdhënie ndërnacionale dalin përvoja të ndryshme, shembuj të mirë të zgjidhjeve praktike, por edhe qasjet që duhet shqyrtuar dhe mësuar si nga ana e Ligjit ër vetqeverisje lokale, ashtu edhe në lidhje me punën veprimtare të këtyre trupave në vetqeverisjet lokale.

Zgjidhja për institucionin i cili deri më 2002, respektivisht deri tek aprovimi i fundit i Ligjit për vetqeverisje lokale, nuk ka ekzistuar në praktikën tonë ligjore dhe në jetën politike dhe shoqërore njësia për vetqeverisje lokale. Në këtë kuptim, çdo përvojë është e mirëseardhur dhe prezanton një hap drejt themelimit të një trupi që do të jetë efikas dhe frytdhënës. Propozimet që vijojnë kanë dalur si nga praktika të komunave të cilat kanë arsimuar këshille për marrëdhënie ndërnacionale, ashtu edhe nga analiza e Ligjit për vetqeverisje lokale, statutet dhe vendimet e kuvendit të komunës dhe hulumtimet të cilat autori me anëtarët e ekipit

të vet i ka bërë në projektin Demokracia lokale dhe Menaxhimi në vetqeverisjet lokale multietnike, nga viti 2002 deri në fund të viti 2005.

Propozimet e dhëna iu janë përshtatur praktikës prezente dhe nenit 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale dhe gjithsesi që as atyre nuk iu krijohet një model ideal i themelimit dhe punës së këshillit për marrëdhënie ndërnacionale. Zgjidhja më e mirë do të ishte që me rastin e ndryshimit të Ligjit për vetqeverisje lokale ky nen të ndryshohet, respektivisht që nenet që janë në kundërshtim dhe termet të harmonizohen si në mes vete ashtu edhe në harmoni me standardet vendore dhe ndërnacionale, e që organi kompetent i administratës bie udhëzime në lidhje me çështjet tjera me rëndësi për themelimin, punën dhe zgjedhjen e anëtarëve të këtyre trupave. Më në fund, duke pasur parasyh që natyra e dispozitave të nenit 63. të Ligjit për vetqeverisje lokale ka të bëjë me mbrojtjen e pakicave lokale, e që në shumicën e vetqeverisjeve lokale pjesëtarët e pakicave nacionale gjenden në situatë të tillë, zgjidhje më e mirë do të ishte të fillohet iniciativa për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale në kuptimin e themelimit të vetqeverisjeve lokale për pakica dhe caktimin preciz të kompetencave të tyre në komuna dhe bashkëpunimin me organet në pushtet.

PROPOZIMET E PËRGJITHSHME

- Këshilli duhet të themelohet në harmoni me Ligjin për vetqeverisje lokale dhe në bazë të statutit të komunës.
- Vetqeverisja lokale multietnike e ka të përcaktuar me ligj obligimin për themelimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale.

- ❑ Këshilli duhet të jetë trup i pavarur punues, që i jep llogari kuvendit të komunës.
- ❑ Anëtarët e këshilleve komunale dhe bartësit e tjerë të pushtetit menaxhues dhe funksioneve nuk duhet të jenë anëtarë të këshillit.
- ❑ Me rastin e marrjes së vendimit për themelimin, kompetencat dhe zgjedhjen e anëtarëve të këshillit duhet patur kujdes për kufizimin e nocioneve bashkësi nacionale dhe etnike dhe pakica nacionale.
- ❑ Ministria për vetqeverisje lokale duhet të gjejë mënyrë me të cilën nuk e then principin e autonomisë së punës së këshillit, të ofrojë ndihmë profesionale dhe juridike në lidhje me interpretimin e nenit 63. dhe nenit 18. të Ligjit për vetqeverisje lokale dhe ndihmë profesionale në lidhje me kompetencat e këshillit nga neni 63. i Ligjit.

REKOMANDIME NË LIDHJE ME PROCEDURËN E THEMELIT TË KËSHILLIT

- ❑ Këshilli duhet të themelohet në bazë të vendimit që e bie kuvendi i komunës.
- ❑ Procedurën e themelimit të këshillit duhet ta fillojë kryetari i komunës.
- ❑ Emërimi i anëtarëve të këshillit duhet të bëhet në bazë të vendimit mbi emërimin të cilin e bie kuvendi i komunës.

REKOMANDIME NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E ANËTARËVE

- ❑ Vendimin për themelimin dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të këshillit duhet publikuar në fletoren zyrtare të kuvendit të komunës.
- ❑ Në situatën prezente procedura e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit duhet formalizuar „butë“.
- ❑ Propozues i anëtarëve të këshillit duhet të jetë kryetari i komunës.
- ❑ Me rastin e përcaktimit të listës së kandidatëve nga radhët e pjesëtarëve të pakicave nacionale duhet kërkuar mendimin e këshilleve të pakicave nacionale. Nëse këshilli nacional i pakicës së caktuar nacionale nuk është formuar, duhet konsultuar shoqatat e pakicave nacionale që janë të regjistruara në komunë. Nëse nuk ka shoqata të regjistruara, propozues mund të jetë këshilli i bashkësisë lokale në të cilën janë të vendosur pjesëtarët e pakicës nacionale.
- ❑ Me rastin e përcaktimit të listës së kandidatëve nga radhët e bashkësisë serbe më së miri është që propozues të jenë grupet këshilltare të kuvendit të komunës nga radhët partiake ose koalicioni partiak që është në pushtet dhe nga radhët e opozitës.
Të dyja grupet e këshilltarëve duhet të propozojnë numër të njejtë të kandidatëve.
- ❑ Nëse anëtari ose anëtarët e këshillit e lëshojnë punën e këtij trupi para fundit të mandatit, propozuesi duhet të ketë të drejtë të propozojë ndryshime.

- ❑ Nëse më shumë se 50% e anëtarëve të këshillit e lënë punën e këtij trupi para fundit të mandatit, kuvendi i komunës duhet të shpartallojë këshillin dhe automatikisht duhet të përsërisë procedurën më së largu 30 ditë nga dita e marrjes së vendimit për ndërprerjen e punës së këshillit.
- ❑ Numrin e anëtarëve të këshillit duhet vendosur me vendimin mbi themelimin.
- ❑ Përbërja nacionale e anëtarëve të këshillit duhet që ose proporcionalisht t'u përgjigjet përbërjes nacionale të popullatës së komunës sipas regjistrimit të fundit të popullatës ose që bashkësitë nacionale të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë.
- ❑ Me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit duhet patur kujdes, nëse është e mundur, që në përbërjen e vet të jenë të përfaqësuar anëtarët nga vendbanimet e ndryshme (bashkësi lokale) në komunë.

REKOMANDIME NË LIDHJE ME KOMPETENCAT

- ❑ Kompetencat themelore të këshillit duhet të dalin nga obligime të parapara me Ligj, të shqyrtojë çështje të realizmit të mbrojtjes dhe avancimit të barazisë nacionale; që para Gjyqit Kushtetues të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit ose ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës.
- Nëse mendon që atyre iu janë dëmtuar të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike të përfaqësuara në këshill dhe

përpara Gjyqit administrativ të fillojë procedurën për vlerësimin e pëlqimit të vendimit ose ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të kuvendit të komunës.

Për qëndrimet e veta në lidhje me realizimin e barazisë nacionale në komunë këshilli duhet ti raportojë rregullisht kuvendit të komunës.

Këshillet duhet të japin mendime për propozimet e të gjitha vendimeve të kuvendit të komunës të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike.

Me vendimin për themelimin e këshillit komunal mundet që, varësisht nga rastet specifike të parashohë edhe kompetenca të tjera. Në lidhje me kompetencat të cilat definoohen më gjerësisht nga kompetencat e parapara me Ligj, duhet patur parasysh siç vijon:

Për realizimin e tyre duhet të parashihen kushte dhe mjete nga burimet dhe buxheti i komunës.

Kompetencat nuk duhet të përputhen me kompetencat e trupave ekzekutuese të komunës dhe kompetencat e trupave tjera punuese të kuvendit të komunës.

Kompetencat nuk duhet të përputhen me kompetencat e këshillit nacional të pakicave nacionale.

Kompetencat e definuara më gjerë mund të bëjnë me:

preventivën dhe zgjidhjen e konflikteve;

promovimin e tolerancës dhe respektimin e llojllojshmërisë;

forcimi i dialogut ndëretnik;

grumbullimin e mendimeve të qytetarëve për gjendjen në lidhje me marrëdhëniet ndërnacionale dhe realizimin e të drejtave të bashkësive nacionale;

përcjellja e ligjit dhe rregullave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale;

- ❑ bashkëpunimin me këshillet nacionale të bashkësive nacionale të cilat janë të përfaqësuara në këshillet komune për marrëdhënie ndërnacionale;
- ❑ bashkëpunimin me institucionet në bashkësitë lokale, krahinë ose republikë të cilat janë të autorizuar për të drejtat e pakicave nacionale, etj;
- ❑ bashkëpunimin me organizatat relevante të shoqërisë civile.

PROPOZIMET NË LIDHJE ME MËNYRËN E PUNËS

- ❑ Këshilli duhet të bie rregullore të punës.
- ❑ Këshilli duhet të takohet para çdo takimi të kuvendit të komunës, e sipas nevojës edhe më shpesh.
- ❑ Kuvendi i komunës duhet që rregullisht t'ia dërgojë anëtarëve të këshillit materialin që ka të bëjë me fushëveprimin e punës së këshillit më së paku shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit të komunës.
- ❑ Anëtarët e kuvendit duhet që vendimet ti bien me anë të konsensusit.
- ❑ Në rast se anëtarët e këshillit nuk janë profesional të japin mendime për propozimin e vendimit ose ndonjë akt tjetër të KK të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e bashkësive nacionale, duhet kërkuar ndihmë profesionale si në vetë njësinë e vetqeverisjes lokale ashtu edhe në institucionet tjera.
- ❑ Me rezultatet e punës, problemet dhe çështjet tjera nga fushëveprimi i punës së këshillit duhet që me kohë të

njoftohen qytetarët, e në takime të caktuara duhet ftuar përfaqësuesit e shërbimeve publike dhe këshilltarët e KK.

- Kurdo që është e mudnur duhet bashkëpunuar me shërbimet profesionale të komunës.
- Duhet themeluar bashkëpunim me Mbrojtësin e të drejtave të qytetarëve në Republikë, Krahinë dhe në komunë.

5

NË VEND TË

Konkluzionit

Ë shtë shumë e sigurtë që Udhëzuesi nuk mund të përmbillet me rekomandime dhe konstruimin e modelit me të cilin do të tejkalohen problemet në lidhje me themelimin, kompetencat dhe zgjedhjen e anëtarëve të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale. Konstruimi i modelit të tillë është i vështirësuar nga më së paku dy arsye. Arsyeja e parë ka të bëjë me kundërshtimet e përshkruara në nenin 63. të Ligjit për vetqeverisjen lokale, kurse e dyta me nevojën reale të shoqërisë demokratike për afirmimin e principeve autonome të vetqeverisjeve lokale. Në këtë kuptim duhet përmbajtur orientimit që Ligji për vetqeverisje lokale të lejojë që sipas situatave specifike njësitë e vetqeverisjes lokale t'i rregullojnë kompetencat e veta në mënyrë të pavarur sipas nevojave dhe situatave specifike të qytetarëve

Në këtë kuptim qytetarët dhe personat kompetent në komunat multietnike duhet të njohin nevojën për themelimin e këtyre trupave dhe në pajtim me Ligjin prezent ti vendosin dhe ti realizojnë. Varësisht nga situata duhet krijuar përbërjen dhe duhet koncipuar punën e këtyre trupave. Në këtë kuptim, Udhëzuesi duhet të jetë një udhërrëfyes i mirë sepse përmban përvoja të deritanishme të komunave në lidhje me punën e këtyre trupave dhe në bazë të tyre ka propozuar zgjidhje potenciale në lidhje me zgjidhjen e disa çështjeve të hapura.

Shtojca 1

STRUKTURA ETNIKE E SERBISË

Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë që u bë në pranverë të vitit 2002, përveç 82,9% të personave që u deklaruan se i përkasin popullatës serbe, 0,92% e qytetarëve që u orientuan për prejardhje malazeze etnike edhe 2,03% të popullatës që nuk u orientua nacionalisht ose u deklarua për përkatësi regjionale, në Serbi jetojnë shumë bashkësi të pakicave etnike, respektivisht pakica nacionale, në mesin e të cilëve më së shumti ka Hungarez me 293.299 pjesëtarë (3,9%), Boshnjakët me 136.087 (2,1%) dhe Romët me 108.193 (1,4%) persona.

Përbërja etnike e popullatës së Serbisë sipas regjistrimit nga viti 2002 (pa Kosovën dhe Metohinë).

PËRKATËSIA ETNIKE	SERBIA	SERBIA QENDRORE	VOJVODINA
GJITHSEJT	7 498 001	5 466 009	2 031 992
Serbë	6 212 838	4 491 031	1 321 807
Malazez	69 049	3 3536	35 513
Jugoslloven	80 721	30 840	49 881

PËRKATËSIA ETNIKE	SERBIA	SERBIA QENDRORE	VOJVODINA
Shqiptarë	61 647	59 952	1 695
Boshnjak	136 087	135 670	417
Bullgar	20 497	18 839	1 658
Bunjevcas	20 012	246	19 766
Vllasë	40 054	39 953	101
Goranët	4 581	3 975	606
Hungarezët	293 299	3 092	290 207
Maqedonët	25 847	14 062	11 785
Muslimanët	19 503	15 869	3 634
Gjermanët	3 901	747	3 154
Romët	108 193	79 136	29 057
Rusët	2 588	1 648	940
Rusinët	15 905	279	15 626
Slovakët	59 021	2 384	56 637
Slovenët	5 104	3 099	2 005
Ukrajnët	5 354	719	4 635
Kroatët	70 602	14 056	56 546
Cekët	2 211	563	1 648
Të tjerët	11 711	6 400	6 311
Të paorientuar	107 732	52 716	55 016
Përkatësia regjionale	11 485	1.331	10 154
Të panjohur	75 483	51 709	23 774

Përkatësia etnike

Burimi: Deklaratë nr. 295, enti Republikan statistikor, Beograd, 2003.

SERBIA QENDRORE

Serbët kanë shumicën absolute në njëqind e dhjetë komuna të serbisë qendrore, Bosnjakët në tri komuna (Tutin 94,2%, Novi Pazar 78,2% dhe Sjenicë 75,5%), Shqiptarët në dy (Preshevë 89,1% dhe Bujanoc 54,7%), përderisa Bullgarët kanë një komunë me shumicë absolute (Bosilegradi 70,9%) dhe një me shumicë relative të popullatës (Dimitrovgradi 49,7%).

Nga bashkësitë tjera etnike, disa janë shumë disperzish të banuara– p.sh. Romët, deri sa të tjerët janë të koncentruar në regjione të caktuara– Vllahët në Serbinë Verilindore.

Më të mëdha në numër nga grupet e pakicave etnokulturore janë bashkësitë nacionale, respektivisht pakicat nacionale të Shqiptarëve, Boshnjakëve, Romëve dhe Vllahëve.

Në tabelën që vijon është dhënë pjesëmarrja e përgjithshme dhe në përqindje e popullatës së bashkësive të pakicave, respektivisht të pakicave nacionale në popullatën e komunave multietnike në Serbi.

Popullata e bashkësive të pakicave në komunitat e Serbisë qendrore

KOMUNA	GJITHSEJTI BANORË	BASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHËSISË PAKICË	%
Qarku i Macvës							
Koceljeva	15.636	Romët	826	5,28			
Qarku i Branicevskit							

KOMUNA	GJITHSEJTBANORË	BASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%
Golubac	9.913	Vlasët	870	8,78			
Zhagubica	14.823	Vlasët	3.268	22,05			
Kucevo	18.808	Vlasët	5.204	27,67			
Petrovac	34.511	Vlasët	3.535	10,24			
Borski okrug							
Bor	55.817	Vlasët	10.064	18,03	Romi	1 259	2,26
Majdanpek	23.703	Vlasët	2.817	11,88			
Negotin	43.418	Vlasët	3.000	6,91			
Zajecarski okrug							
Boljevac	15.849	Vlasët	4.162	26,26	Romi	229	1,44
Zlatiborski okrug							
Nova Varosh	19.982	Boshnjakët	1.028	5,14	Muslimanët	502	2,51
Priboj	30.377	Boshnjakët	5.567	18,33	Muslimanët	1 427	4,70
		Malayeyët	432	1,42			
Prijepolje	41.188	Boshnjakët	13.109	31,83	Muslimanët	3 812	9,26
Sjenica	27.970	Boshnjakët	20.512	73,34	Muslimanët	659	2,36
Qarku i Rashkës							
Novi Pazar	85.996	Boshnjakët	65.593	76,27	Muslimanët	1 599	1,86
Tutin	30.054	Boshnjakët	28.319	94,23			
Qarku i Nishavës							
Doljevac	19.561	Romi	1.049	5,36			
Toplecki okrug							
Zhitoradja	18.207	Romi	1.142	6,27			
Pirotski okrug							
Babushnica	15.734	Bullgarët	1.107	6,46			
Bela Palanka	14.381	Romët	1.228	8,54			
Dimitrovgrad	11.748	Bullgarët	5.836	49,68	Jugosllavët	472	4,02
Jablanicki okrug							
Bojnik	13.118	Romët	1.363	10,39			

KOMUNA	GJITHSEJTI BANORË	BASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHËSISË PAKICË	%
Medvegja	10.760	Shqiptarët	2.816	26,17	Romët	108	1,00
		Malazezët	372	3,46			
Qarku i Pčinjës							
Bosilegradi	9.931	Bullgarët	7.037	70,86	Jugosllavët	288	2,90
Bujanoci	43.302	Shqiptarët	23.681	54,69	Romët	3 367	8,93
Vranje	87.288	Romët	4.647	5,32			
Presheva	34.904	Shqiptarët	31.098	89,10			
Surdulica	22.190	Romët	2.119	9,55			
Bojnik	13.118	Romët	1.363	10,39			

Burimi: Qendra për hulumtimin e etniciteteve, hulumtim dhe menaxhim në komunat multietnike, 2004 – 2005.

VOJVODINA

Në strukturën etnike të Vojvodinës, përveç bashkësisë serbe më të madhe, një pjesëmarrje me rëndësi e përbëjnë edhe pjesëtarët e bashkësive nacionale të pakicave. Hungarezët të cilët janë gjithsej 14,3% e populltës së përgjithshme në KP të Vojvodinës, shumicën absolute të popullatës e realizojnë në gjashtë komuna: Kanjizha 86,5%, Senta 80,5%, Adi 76,6%, Baçka Topollë 58,9%, Malli Igjosh 55,9% dhe Çokë 51,6%. Shumicën relative të popullatës e realizojnë në Becej– 48,8% dhe në Suboticë– 38,5%. Pjesëtarë të bashkësisë nacionale kroate ka 2,78%, e sllovaqe 2,79%. Rumune 1,5%; Romë 1,43%; Bunjevac 0,97%; Rusinë 0,77%; Maqedonë 0,58%; Ukrainjë 0,23; Ukrainac 0,23%; Muslimanë 0,18%; Gjermanë 0,16%, Slovenë 0,1; Shqiptarë, Bullgarë dhe Cek nga 0,08%; Rusë 0,05%; Goranë 0,03%;

Boshnjakë 0,02% dhe Vllahë 0,01%. Përveç këtyre bashkëisve nacionalenë Vojvodinë 2,45% e qytetarëve është deklaruar që i përket bashkësisë Jugoslovene. Në disa bashkësi lokale numri i tyre nuk është i parëndësishëm, veçanërisht jo në Suboticë ku ka 8.562 ose 5,77%, Baçka Topollë – 831 ose 2,17%, Sombor – 5.098 ose 5,24% ose në Pançevë – 2.992

ose 2,35%. Edhe në 19 komuna Jugosllavët përbëjnë në mes 1 dhe 2% të popullatës dhe në bazë të kësaj ndikojnë në formimin e këshilleve për marrëdhënie ndërnacionale.

Përveç pjesëtarëve të bashkësisë hungareze asnjë bashkësi nacionale e pakicave, respektivisht pakicë nacionale, nuk ka shumicë absolute në ndonjë nga komunat e Vojvodinës. Prandaj, shumica e komunave të Vojvodinës është multi-etnike respektivisht pjesëtarët e pakicave përbëjnë pjesë të rëndësishme të popullatës.

Në tabelën që vijon është dhënë struktura nacionale e bashkësive të pakicave nacionale në komunat e Vojvodinës.

Popullata e bashkësive të pakicave në komunat e Vojvodinës

KOMUNA	GJITHSEJT BANORË	BASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHKËSISË PAKICË	%	NASHKËSIA E PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVE TË BASHKËSISË PAKICË	%
Qarku i Banatit Verior							
Baçka Topola	38.245	Hungarezët	22.543	58,9	Jugosllavët	831	2,17
		Kroatët	454	1,19	Malazezët	547	1,43
Malli Igjosh	13.494	Hungarezët	7.546	55,9	Malazezët	2.812	20,84
		Romët	138	1,02			
Suboticë	148.401	Hungarezët	57.092	38,4	Kroatët	16.688	11,25
		Bunjevcasit	16.254	10,9	Jugosllavët	8.562	5,77
		Malazezët	1.860	1,25			

KOMUNA	GJITHSEJTBANORË	BASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%
Qarku i Banatit të Mesëm							
Zhitishte	20.399	Hungarezët	4.017	19,69	Rumunët	1.837	9,01
		Romët	765	3,75	Jugosllavët	266	1,30
Zrenjanini	132.051	Hungarezët	14.211	10,76	Rumunët	2.511	1,90
		Romët	2.471	1,87	Jugosllavët	2.559	1,94
		Sllovakët	2.403	1,82			
Nova Crnja	12.705	Hungarezët	2.369	18,65	Romët	869	6,84
Novi Becej	26.924	Hungarezët	5.177	19,23	Jugosllavët	567	2,11
		Romët	968	3,60			
Secanj	16.377	Hungarezët	2.068	12,63	Jugosllavët	266	1,62
		Rumunët	642	3,92	Romët	609	3,72
Qarku i Banatit verior							
Ada	18.994	Hungarezët	14.558	76,65	Jugosllavët	275	1,45
		Romët	277	1,46			
Kanjizha	27.510	Hungarezët	23.802	86,52	Romët	530	1,93
Kikinda	67.002	Hungarezët	8 607	12,85	Jugosllavët	1.670	2,49
		Romët	1.564	2,33			
Novi Knezevac	12.975	Hungarezët	3.864	29,78	Jugosllavët	207	1,60
		Romët	655	5,05			
Senta	25.568	Hungarezët	20.587	80,52	Jugosllavët	392	1,53
		Romët	581	2,27			
Coka	13.832	Hungarezët	7.133	51,57	Jugosllavët	228	1,65
		Romët	337	2,44	Sllovakët	201	1,45
Qarku i Banatit Jugor							
Alibunar	22.954	Rumunët	6.076	26,47	Sllovakët	1.195	5,21
		Romët	657	2,86	Hungarezët	309	1,35
Bela Crkva	20.367	Rumunët	1.101	5,41	Cekët	814	4,00
		Romët	619	3,04	Jugosllavët	283	1,39
		Hungarezët	459	2,25			

KOMUNA	GJITHSEJTBANORË	BASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%
Vërshac	54.369	Rumunët	5.913	10,88	Jugosllavët	1.109	1,87
		Hungarezët	2.619	4,82	Romët	1.186	2,18
Kovacica	27.890	Slovakët	11.455	41,07	Jugosllavët	349	1,25
		Hungarezët	2.935	10,52	Rumunët	1.950	6,99
Kovin	36.802	Hungarezët	3.408	9,26	Rumunët	1.363	3,70
		Romët	1.143	3,11			
Pancevë	127.162	Hungarezët	4.037	3,17	Maqedonët	5.276	4,15
		Rumunët	4.065	3,20	Slovakët	1.578	1,24
		Romët	1.392	1,09	Jugosllavët	2.992	2,35
Plandishte	13.377	Hungarezët	1.619	12,10	Maqedonët	1.297	9,70
		Rumunët	965	7,21	Jugosllavët	300	2,24
		Slovakët	725	5,42	Romët	269	2,01
Qarku i Backës Perëndimore							
Apatin	32.813	Hungarezët	3.785	11,54	Kroatët	3.766	11,48
		Rumunët	1.191	3,63	Jugosllavët	727	2,22
		Romët	524	1,60			
Kulla	48.353	Malazezët	7.902	16,34	Rusinët	5.389	11,19
		Hungarezët	4.082	8,46	Ukrajnët	1.453	3,01
		Kroatët	806	1,67	Jugosllavët	740	1,53
Oxhaci	35.582	Hungarezët	1.572	4,42	Slovakët	1.002	2,82
		Romët	839	2,36			
Sombor	97.263	Hungarezët	12.386	12,73	Jugosllavët	5.098	5,24
		Kroatët	8.106	8,33	Bunjevicasit	2.730	2,81
Qarku i Banatit Jugor							
Baç	16.268	Slovakët	3.213	19,57	Kroatët	1.389	8,54
		Hungarezët	992	6,10	Jugosllavët	805	4,95
		Rumunët	570	3,50	Muslimanët	216	1,33
		Romët	318	1,95			
Baçka Palanka	60.966	Slovakët	5.837	9,57	Hungarezët	1.490	2,44

KOMUNA	GJITHSEJTBANORË	BASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%
		Kroatët	982	1,61	Jugosllavët	1.041	1,71
		Romët	841	1,38			
Baçki Petrovac	14.681	Slllovakët	9.751	66,42	Jugosllavët	293	2,00
Beocin	16.086	Romët	1.048	6,51	Slllovakët	959	5,96
		Kroatët	757	4,71	Jugosllavët	861	5,35
		Hungarezët	288	1,79			
Becej	40.987	Hungarezët	20.018	48,84	Jugosllavët	1.070	2,61
		Romët	479	1,17	Kroatët	437	1,07
Vërbas	45.852	Malazezët	11.371	24,80	Rusinët	3.765	8,21
		Hungarezët	2.885	6,29	Ukrajnët	975	2,13
		Kroatët	659	1,44	Jugosllavët	675	1,47
Zhabalj	27.513	Rusinët	1.407	5,11	Romët	768	2,79
		Hungarezët	305	1,11			
Novi Sad	299.294	Hungarezët	15.687	5,24	Jugosllavët	9.514	3,18
		Slllovakët	7.230	2,42	Kroatët	6.263	2,09
		Malazezët	5.040	1,68			
Sërbobran	17.855	Hungarezët	3.920	21,95	Jugosllavët	462	2,59
		Romët	361	2,02			
Sremski Karlovci	8.839	Kroatët	753	8,52	Jugosllavët	254	2,87
		Hungarezët	215	2,43	Malazezët	89	1,01
Temerin	28.257	Hungarezët	8.341	29,50	Jugosllavët	407	1,44
Titel	17.050	Hungarezët	902	5,29	Jugosllavët	318	1,87
		Romët	229	1,34			
Qarku i Sremit							
Inxhija	49.609	Hungarezët	962	1,94	Jugosllavët	969	1,95
		Kroatët	1.904	3,84			
Irig	12.329	Hungarezët	816	6,62	Jugosllavët	295	2,39
		Kroatët	289	2,34			
Stara Pazova	67.576	Slllovakët	5.992	8,87	Jugosllavët	754	1,12

KOMUNA	GJITHSEJTBANORË	BASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%	NASHKËSIAE PAKICËS	NUMRI I PJESËTARËVETË BASHËSISË PAKICË	%
		Kroatët	1.615	2,39	Romët	1.085	1,61
Shid	38.973	Slovakët	2.521	6,47	Kroatët	2.086	5,35
		Rusinët	1.318	3,38	Jugosllavët	739	1,90

Burimi: Qendra për hulumtimin e etnicitetit, hulumtimi; Menaxhimi në komunat multietnike, 2004 – 2005.

Sbtojca 2

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PAKICAVE NACIONALE

Shumë çka nga ajo që u tha, e sidomos të vërejtur në praktikë në këshillet komunale për marrëdhënie ndërnacionale, tregon për atë që kompetencat dhe praktika e këtyre trupave kryesisht ka të bëjë me të drejtat e pakicave nacionale. Puna e anëtarëve të këshillit për marrëdhënie ndërnacionale edhe në të ardhmen më shumë do të merret me shqyrtimin e vendimeve të kuvendit të komunës në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave nacionale. Fundja, këto trupa janë themeluar në komunat multietnike në të cilat duhet të implementohet dhe kontrollohet realizimi i të drejtave të pakicave nacionale, të cilat iu janë garantuar me standardet ndërnacionale dhe legjisllacionin nacional të mbrojtjes së pakicave.

STANDARDET NDËRNACIONALE TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË PAKICAVE NACIONALE

Gjatë dekadës së fundit në Evropë u avancuan standardet e mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale. Disa autorë konkludojnë që është zhvilluar e drejta evropiane partikulare e dedikuar mbrojtjes së pakicave, si dhe ndikim të vendosur në zhvillimin e vetëdijes politike dhe ligjore në lidhje me avancimin e të drejtave dhe pozitave të pakicave etnokulturore kanë pasur institucionet ndërnacionale evropiane— Këshilli i Evropës dhe Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë. Me këtë proces Këshilli i Evropës ka filluar qysh në vitin 1950 me adaptimin e Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e është vazhduar me aprovimin e Kartës së Evropës për gjuhët regjionale ose të pakicave (1992), dhe tre vjet pas kësaj me hapjen për nënshkrim dhe ratifikim të Konventës kornizë për mbrojtjen e të drejtave nacionale, deri më tani të vetmin instrument multilateral të mbrojtjes së të drejtave të pakicave në Evropë.

Karta Evropiane për gjuhët regjionale dhe të pakicave

Instrumenti i parë të cilin Këshilli i Evropës e ka aprovuar në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e identitetit të pakicave etnokulturore është karta Evropiane për gjuhët regjionale të pakicave të cilën në fillim të dekadës së nëntë të shekullit XX e ka

inicuar Konferenca e përhershme e atëhershme, e sot Kongresi i pushtetit lokal dhe regional i Evropës.

Qëllimi i Kartës është të ndihmojë ruajtjen e pasurisë gjuhësore të Evropës si pjesë e trashëgimisë kulturore. Në këtë kuptim, shtetet nënshkruese të kartës obligohen në ndërmarrjen e masave që i ndihmojnë ruajtjes dhe zhvillimit të gjuhëve regjionale dhe të pakicave në aspekte të ndryshme të jetës shoqërore dhe private. Si gjuhë regjionale nënkuptohen ato gjuhë të cilat fliten në një pjesë të territorit të ndonjë shteti, e gjuhë të pakicave konsiderohen ato gjuhë të cilat i flasin personat të cilët homogjenisht nuk janë banorë të ndonjë vendi dhe numri i tyre është më i vogël se i personave të cilët e flasin gjuhën e shumicës.

Qëllimet e Kartës janë themeluar në faktet që në çdo shtet evropian pjesët e popullatës flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha që është në përdorim zyrtar dhe me të cilin më së shpeshti flasin pjesëtarët e grupit më të madh gjuhësor (etnik), e gjuhëve të pakicave nuk iu kushtohet mjaft rëndësi. Përveç kësaj, disa gjuhë janë të përhapura në më shumë shtete kështu që gjuha që është në përdorim zyrtar në njërin, bëhet gjuhë e pakicave në shtetin tjetër. Gjithashtu, në bazë të një gjuhe fliten më shumë dialekte, të cilët në kuptimin e pasurisë së llojlojshmërisë, duhet të kenë kushte të njëjta për ruajtje.

Kartën e Evropës për gjuhët regjionale dhe të pakicave Serbia, respektivisht bashësia e Serbisë dhe Malit të Zi¹⁴ e ka ratifikuar në vitin 2005, e në Kuvendin e Serbisë dhe Malit të Zi shpejtë pas kësaj u aprovua një propozim masash dhe mekanizmash me të cilat mbrohen gjuhët e pakicave.

14 Karta hyri në fuqi më 1 Mars të vitit 1998, tre muaj pasi që Kartën e ratifikuan pesë shtete, anëtare të Evropës. Deri më tani Kartën e kanë ratifikuar njëzet shtete— Austria, Danimarka, Finlanda, Jermenia, Holanda, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Hungaria, Gjermania, Norvegjia, Kroacia, Qipri, Sllovenia, Sllovakia, Serbia dhe Mali i Zi, Spanja, Suedia, Zvicra, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe.

Në dokumentet të cilat Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave pas konsultimit me resoret e ministrive në shtetet anëtare ia dërgoi parlamentit të bashkësisë shtetërore në lidhje me ratifikimin e Kartës shihet se në Serbi organet e administratës, kanë vendosur që në kuptimin e Kartës, si gjuhë regjionale dhe të pakicave konsiderohen: Gjuha shqipe, boshnjake, bullgare, hungareze, rome, rumune, rusine, sllovaqe, ukrainase dhe kroate. Në praktikë kjo do të thotë që këto gjuhë duhet të jenë të përfaqësuara në jetën publike në komunat në të cilat pjesëtarët e pakicave nacionale përbëjnë 15% të popullatës ose ato të drejta t'i realizojnë në bazë të nenit 8. të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale dhe nenit 57. të Kartës për të drejtat e nejiut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve me të cilat garantohej realizimi i të drejtave të fituara. Përveç përdorimit zyrtar të gjuhës në bashkësitë lokale do të implementohen edhe të gjitha të drejtat e tjera që janë në lidhje me përdorimin e gjuhëve të pakicave nacionale në arsimim, informim, me rastin e zgjedhjeve lokale dhe të tjera.

Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale

Me konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale janë përcaktuar parime dhe principe, respektivisht minimumi i kufijve të mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale në të cilat shtetet të cilat të ardhmen e ndërtojnë në bazë të rrjedhave të integracionit evropian, duhet tu sigurojnë pjesëtarëve të pakicave nacionale. Në këtë kuptim, dispozitat e Konventës kornizë, nuk janë të obliguara ndaj shteteve nënshkruese të cilave iu është lënë e drejta diskrete, t'i përcaktojnë modalitetet e implementimit të qëllimeve të saj.

Duke respektuar rrethanat specifike jo vetëm në regjionet e ndryshme evropiane por edhe në çdo shtet si dhe faktin që

në bazë të Këshillit Evropian ekzistojnë shtete të cilat ndryshe shikojnë marrëdhëniet e shumicave dhe pakicave, Konventa kornizë përcakton parime dhe principe të mbrojtjes së pakicave të aplikuara me parimet e demokracisë evropiane.

Me Konventën nuk jipen të drejtat konkrete të pjesëtarëve të pakicave nacionale, por përcaktohen aktivitetet e dëshiruara dhe masat të cilat duhet ti ndërmarrin shtetet për të krijuar kushte për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pakicave.

Shtetet i pranojnë këto obligime duke menduar që „mbrojtja e pakicave nacionale dhe të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të pakicave përfaqësojnë pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërnacionale të të drejtave të njeriut...“ (neni 1.), si dhe atë që mbrojtja e pakicave realizohet në bazë të „sundimit të të drejtave“, respektimit të tërësisë territoriale dhe suverenitetit të shteteve“ (preambula). Ky konstatim i fundit, edhe pse i provincencës parimore, duket i rëndësishëm veçanërisht nga ana e shteteve, sepse shprehë obligime të pakicave në pikëpamje të marrëdhënieve ndaj shtetit dhe institucioneve të tij. Në këtë kuptim edhe neni 20. i Konventës kornizë i cili nga pakicat kërkon të respektojë legjislacionin dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht kur pjesëtarët e pakicave nacionale përbëjnë shumicën në pjesën e territorit të ndonjë shteti. Karakteristikat tjera të Konventës kornizë i kanë hapur qasje definicionit të pakicave nacionale dhe marrëdhënies ndaj të drejtave kolektive. Edhe pse në literaturë mund të gjenden definicione të numërta të nocionit pakica nacionale, Konventa kornizë nuk operacionalizohet me asnjë, por i len mundësi pjesëtarëve të pakicave që të orientohen që ndaj tyre të sillen ashtu ose jo (neni 3).

Prandaj, zgjedhja subjektive e individëve është e lidhur me kriteriumet objektive relevante për identitetin e vet. Në lidhje me këtë është marrëdhënia ndaj të drejtave kolektive të cilën nuk e përmend Konventa kornizë, por me formulimin që pjesëtar i pakicës nacionale të drejtat i realizon individualisht ose „në

bashkësi me të tjerët“ është hapur mundësia që të drejtat e caktuara mund të realizohen bashërisht respektivisht në grup.

Konventa kornizë iu rekomandon shteteve:

- ❑ Që të përmbahen nga asimilimi i dhunshëm i pakicave nacionale dhe të nxisin krijimin e kushteve për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kulturës dhe identitetit të pakicave nacionale (neni 5).
- ❑ Të krijojnë kushte për qasje të hapur në media, përdorimin e gjuhës amtare në jetën private dhe publike, arsimimin në gjuhën e pakicave në të gjitha nivelet dhe pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore dhe të kryejnë punë publike (neni 10–15).
- ❑ Në rastet e tejkaluara të njëjësive ekzistuese të vetqeverisjes lokale ose administratës shtetërore me të cilat zvogëlohen të drejtat e fituara ose ekzistuese të pakicave nacionale.
- ❑ Që pjesëtarëve të pakicave t’iu mundësojnë themelimin autonom dhe mbajtjen e lirë dhe paqësore të kontakteve me shtetet amë, e që nga ana e vet me qëllim të avancimit të të drejtave të pakicave të nxisin dhe të marrin pjesë në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale, si dhe të zhvillojnë bashkëpunimin ndërkuftar. (neni. 17. i 18).

Implementimin e të drejtave të pakicave nacionale që janë në përmbajtjen e Konventës kornizë në shtetet nënshkruese e përcjell Komiteti i ministrave i cili për këtë qëllim e ka themeluar Komitetin këshilldhënës, anëtarët e të cilit janë profesinist të mëdhenj në lëminë e të drejtave të pakicave.

Komiteti këshilldhënës, si trup i pavarur i ekspertëve e përcjell implementimin dhe realizimin e të drejtave të pakicave nacionale në shtetet nënshkruese të Konventës jo vetëm me anë të raporteve të cilat i dërgojnë shtetet dhe organizatat joqeveritare (shadoë report) por kërkon edhe mendime, sqarime shpesë dhe planifikon dhe bën vizita me qëllim të vlerësimit të gjendjes.

Raportet shtetërore përmbajnë informata për realizimin e masave të ndërmarra dhe afirmimin e parimeve të Konventës kornizë, si dhe informata për aktivitetet konkrete ta cilat realizohen përmes ligjeve relevante dhe politikës. Vëmendje të posaçme në këtë proces kanë organizatat joqeveritare të cilat Komitetit këshilldhënës i dërgojnë raporte alternative të cilat shqyrtohen dhe barazohen me raportet shtetërore që problemet e pakicave të shikohen në mënyrë sa më objektive, precize dhe komplete. Në bazë të analizës së të dhënave shtetërore dhe informatave të marra nga burimet e pavarura, Komiteti këshilldhënës bie mendim dhe ia dorëzon Komitetit të ministrave.

Deri më tani Konventën kornizë e kanë nënshkruar dyzet e një shtet, kurse e kanë ratifikuar tridhjetë e shtatë shtete. Bashkësia e shteteve Serbi dhe Mali i Zi e ka dërguar raportin e parë për implementimin e Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, më 16 Tetor të vitit 2003, kurse mendimin për këtë Komiteti këshilldhënës e ka aprovuar në mbledhjen e XVIII, të mbajtur më 27. Nëntor të viti 2003.¹⁵ Mendimi i Komitetit këshilldhënës ka qenë pozitiv më së shumti duke iu falënderuar aprovimit të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale dhe Kartën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe lirive të qytetarëve, por me një varg të rekomandimeve serioze të cilat duhet përmbushur për të realizuar të drejtat e parapara.

Njësitë e vetqeverisjes lokale në Serbi në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave, Kartës për të drejtat e njeriut dhe të pakicave si dhe lirive të qytetarëve e veçanërisht nenit 28. të Ligjit për vetqeverisje lokale, janë të obliguara të sigurojnë kushte për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale të përmendura në Konventën kornizë.

Në lidhje me punën e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale kjo do të thotë që anëtarët e këtij trupi duhet të japin mendime në lidhje me çdo vendim të kuvendit të komunës, që kanë të

15 ACFC/OP/I(2003)008.

bëjnë me të drejtat e pakicave nacionale, respektivisht me të cilat mund të ndikohet pozitivisht në barazinë nacionale, e në rast se ajo thyhet, dhe të fillojnë iniciativën për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Marrëveshjet bilaterale për mbrojtjen e të drejtve të pakicave nacionale

Marrëveshjet bilaterale për mbrojtjen e pakicave janë instrumente me të cilat shtetet mes vete rregullojnë çështje specifike në lidhje me të drejtat dhe statusin e pakicave nacionale. Deri më sot në regjionet e Evropës qendrore dhe juglindore, marrëveshje kanë lidhur: Hungaria– me të gjithë fqinjët e vet;

Rumania – përves Hungarisë edhe me Ukrainën dhe Serbinë dhe Malin e Zi Slovenia me Kroacinë, Hubgarinë dhe Italinë, kurse Kroacia përveç me Slloveninë edhe me Hungarinë, Italinë dhe Serbinë dhe Malin e Zi; Polonia me Lituaninë dhe Rusinë Serbia, respektivisht bashkësia e shtetit Serbi dhe Mali i Zi, përveç marrëveshjeve të përmendura me Rumaninë, Hungarinë dhe Kroacinë, ka arritur marrëveshje të ndërsjellë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale edhe me Maqedoninë.

Rekomandimet e Komisarit të Lartë të OSBE-së

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE), nga dokumenti përfundues nga takimi në Helsinki (1975), i kushton rëndësi mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale. Edhe pse çështjet e pakicave nacionale nuk u shqyrtuan me të njëjtën vëmendje në takimet e OSBE-së, e ndikimi i kësaj organizate kurrë në mënyrë direkte nuk është marrë me këto çështje, përveç në raste kur tensionet ndërnacionale kanë kanosur

rrezik për të prishur paqen në Evropë, është i pa dyshimtë ndikimi të cilin misionet, institucionet dhe dokumentet e OSBE-së e kanë realizuar në lidhje me standardizimin e të drejtave të pakicave nacionale.

Në lidhje me këtë OSBE, pas adaptimit të Dokumentit nga takimi në Helsinki më 1992, e ka themeluar Zyren e Komisarit të Lartë për pakica nacionale.

Institucioni i Komisarit të lartë duhej të kishte rol preventiv në situatat të cilat si pasojë mund të kishin konflikte ndërnacionale. Detyrat e Komisarit të Lartë, i cili rekrutohet nga radhët e diplomatëve dhe politikanëve të shquar Evropian, janë që me kohë të sigurojë vërejtje, e sipas nevojës, edhe aksion të hershëm me qëllim të parandalimit të konfliktit. Në praktikë kjo do të thotë edhe që Komisari i Lartë, respektivisht zyra e tij, e cila është themeluar në Hagë mbledh dhe pranon informata për çështjet e pakicave nacionale dhe vlerëson në fazën më të hershme rolin e palëve të ndërhyra në mënyrë direkte, historinë dhe natyrën e konfliktit dhe propozon masa për tejkalimin e situatave të tilla të cilat nënkuptojnë edhe avancimin e dialogut, mirëbesimit dhe bashkëpunimit në mes të palëve në konflikt.

- Duke u munduar të avancojë implementimin e të drejtave të pakicave nacionale Zyra e Komisarit të Lartë ka përgatitur rekomandime të cilat kanë të bëjnë me arsimimin (1996), përdorimin zyrtar të gjuhës (1998) dhe pjesëmarrje aktive në jetën publike (1999). Edhe pse rekomandimet nuk kanë karakter obligues, rëndësia e tyre është e madhe për implementimin e standardeve të fituara në nivelin nacional, regjional dhe lokal. Më së shpeshti këto të drejta pjesëtarët e pakicave nacionale i realizojnë në bashkësi me bashkëatdhetarët e vet në vendet dhe regjionet në të cilat kryesisht janë të vendosur, e më rrallë në vendet ku janë të disperzuar ambientalisht.

- Duke u përpjekur që të sigurojnë realizimin e të drejtave për arsimim, me anë të rekomandimeve, veç tjerash sugjerohen masat të cilat duhet ndërmarrë në bashkësitë lokale. Në këtë kuptim shtetet duhet të krijojnë kushte të cilat do ti mundësojnë institucioneve në të cilat janë të përfaqësuar pjesëtarët e pakicave nacionale, që në mënyrë të menduar mië të marrin pjesë në zhvillimin dhe realizimin e politikës dhe programit të cilat kanë të bëjnë me arsimimin e pakicave. Në këtë kuptim shtetet duhet që ti bartin kompetencat e duhura në pushtetin regional dhe lokal, në lëminë e arsimit të pakicave, dhe kështu njëkohësisht e lehtësojnë pjesëmarrjen e pakicave në procesin e formimit politik në nivelin regional dhe lokal. Përveç kësaj shtetet duhet të aprovojnë masa me të cilat do të nxisin kyçjen e e prindërve dhe mundësinë e tyre të zgjedhjes së sistemit në nivelin lokal, përveç tjerash edhe në lëminë e arsimimit në gjuhën e pakicave (Hag 1996).
- Roli i pushtetit regional dhe lokal në procesin e realizimit të të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës gjithashtu është apostrofuuar në Rekomandimet nga Oslo nga viti 1998: në vendet në të cilat jeton numër i madh i pjesëtarëve të pakicave nacionale, dhe nëse për këtë ekziston kërkesë e arsyeshme, organet e pushtetit janë të obliguara të mundësojnë shprehjen e emrave lokal, emrat e rrugëve, dhe shenja të tjera topografike edhe në gjuhën e pakicës nacionale.

Mandej, në regionet dhe vendet ku jeton numër i madh i pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe ku për këtë ekziston dëshirë e shprehur, ata duhet të kenë të drejtë që nga autoritetet regjionale ose lokale dhe institucionet publike të marrin dhe vërtetojnë dokumentet personale në gjuhën zyrtare ose shtetërore dhe gjuhët e pakicave nacionale.

Gjithashtu autoritetet regjionale ose lokale dhe institucionet publike duhet ruajtur dokumentacionin relevant të qytetarëve edhe në gjuhën e pakicave nacionale.

Edhe pjesëtarët e pakicave nacionale duhet të kenë mundësi të përdorin gjuhën e vet gjatë komunikimit me organet e administratës, veçanërisht në regjionet dhe vendet ku është shprehur dëshirë e tillë dhe ku jetojnë në numër të madh, si dhe në vendet të cilat kryesisht ose në numër të madh janë të banuara nga pjesëtarët e pakicave nacionale, shteti duhet të ndërmarrë masa me të cilat do të sigurojë që anëtarët e zgjedhur të organeve shtetërore regjionale dhe lokale mund të përdorin edhe gjuhën e akicave nacionale me rastin e punës në trupa të tillë.

- Në lidhje me pjesëmarrjen aktive të pakicave nacionale në jetën publike, kujdes i njejtë iu është kushtuar pjesëmarrjes së pakicave në realizimin e pushtetit në nivelin qendror, regjional dhe lokal. Për këtë qëllim, shtetet por edhe pushtetet lokale mund të ndërmarrin masa të veçanta me të cilat sigurohen vende të garantuara për përfaqësues të pakicave nacionale në trupat prezantues dhe ekzekutues, e munden që edhe sistemin zgjedhor ta rregullojnë në mënyrë që pakicave nacionale t’ia lehtësojnë përfaqësimin dhe ndikimin.

Me dokumentet e dhëna në listë të cilët prezantojnë instrumentet më të vlefshme të mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale në Evropë, nuk janë shuar mundësitë e avancimit të gjendjes në këtë lëmi. Iniciativat regjionale, bashkëpunimi i ndërsjellë i shteteve, regjioneve dhe pushteteve lokale themelojnë standarde të krijura për raste konkrete, e të cilët për qëllim mund të kenë avancimin e gjendjes dhe ruajtjen e identitetit të pakicave nacionale, tejkalimin e mosdurimit ose në mënyrë preventive ndikojnë në situatat e tensioneve etnike.

POZITA E TË DREJTËS KUSHTETUESE E PAKICAVE NACIONALE NË SERBI

Themeli i mbrojtjes së të drejtës kushtetuese të pakicave nacionale në Serbi paraqet të drejtat e njohura me:

- Kartën kushtetuese të bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi,
- Kartën për të drejtat e njeriut, të pakicave dhe liritë e qytetarëve,
- Kushtetutën e Serbisë,
- Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale,
- Ligjin për vetqeverisjen lokale.

Karta kushtetuese e bashkësisë shtetërore Serbi dhe Mali i Zi

Karta kushtetuese parimisht rregullon garancionet kushtetuese të mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale. Në nenin 9. është theksuar obligimi i shteteve anëtare, Serbi dhe Mali i Zi, të rregullojnë, sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve në territorin e vet“ si dhe „niveli i fitur i të drejtave të njeriut dhe të pakicave, liritë individuale, kolektive dhe të qytetarëve nuk mund të zvogëlohen“.

Me alinenë tjetër të nenit të njëjtë përcaktohet fushëveprimi i kompetencave të bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të

Zi në drejtim të realizimit të të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve: „Serbia dhe Mali i Zi përcjell realizimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve dhe siguron mbrojtjen e tyre në shtetet anëtare.

*Karta për të drejtat e njeriut dhe të pakicave
dhe liritë e qytetarëve*

*Kushtetuta e Serbisë dhe Ligji për mbrojtjen e të
drejtave dhe lirive të pakicave nacionale*

Definicioni i nocionit pakicë nacionale – qasja e së drejtës kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të pakicave

Karta për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe lirive të qytetarëve shumë më detajisht e përcakton listën e të drejtave që iu janë premtuar pakicave nacionale. Por, duhet përmendur edhe se shumica e të drejtave të njohura me këtë Kartë ka qenë e njohur edhe me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale që i ka paraprirë. Lidhshmëria e këtyre dy dokumenteve është e dukshme dhe disa definicione kushtetuese edhe pse nuk përmenden në mënyrë direkte në kartë janë marrë nga Ligji. Në këtë drejtim me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale është përcaktuar që të mbrohen identitetet e bashkësive të pakicave pavarësisht nga numri i tyre dhe është adaptuar qasje e hapur e definimit të identiteteve të pakicave, respektivisht me Ligj është mundësuar që kuptimet e ndryshme të identiteteve munden në kuptimin më të gjerë të vetëdijes nën nocionin e përgjithshëm të pakicave nacionale: pakicë nacionale në kuptimin e këtij ligji është çdo grup i shtetasve të RF të Jugosllavisë i cili sipas numrit është mjaft reprezentues,

edhe pse paraqet pakicë në RF të Jugosllavisë, i takon ndonjërs nga grupet e popullatës të cilët janë në lidhje të gjatë dhe të fortë me territorin e RFJ dhe posedojnë shenja si që janë gjuha, kultura, përkatësia nacionale ose etnike, prejardhja ose religjioni, me anë të së cilave dallohen nga shumica e popullatës dhe pjesëtarët e së cilës dallohen për shkak të kujdesit që bashkërisht të mirëmbajnë identitetin e tyre të përbashkët duke përfshirë kulturën, traditën gjuhën dhe religjionin.

Pakicë nacionale në kuptimin e këtij Ligji do të konsiderohen të gjitha grupet e shtetasve të cilat thirren ose përcaktohen si popuj, të bashkësisë nacionale ose etnike, grupe nacionale ose etnike, nacionalitete dhe kombësi e i përmbushin kushtet nga alinea 1. e këtij neni¹⁶

Kushtetuta e Serbisë në shikimin e definicionit të pakicës nacionale është e tejkaluar sepse operacionalizohet me nocionin kombësi i cili është shumë vështirë të sqarohet në literaturën profesionale kurse në përcaktimin kushtetues duhet të i përkasë pakicave nacionale dhe bashkësisë etnike.

Ndalimi i diskriminimit dhe masat e aksionit afirmativ

Një nga vendet e rralla nga i cili janë harmonizuar të gjitha dokumentet bazike për mbrojtjen e të drejtave të pakicave është ndalimi i diskriminimit të qytetarëve sipas çfarëdo baze, por edhe në bazë të rasës, prejardhjes etnike, përkatësisë nacionale, religjionit, gjuhës.¹⁷

Me ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, e më vonë edhe Kartën e Vogël, në praktikën tonë

16 „Fl. yzrtare e RFJ“, nr.11, 27. Shkurt, 2002.

17 Të shihet: Karta për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe lirive të qytetarëve, neni 2 Kushtetuta e Serbisë, neni 13 Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, neni 3.

të së drejtës kushtetuese është futur nocioni i aksionit afirmativ, respektivisht diskriminimit pozitiv. Për dallim nga Kushtetuta e Serbisë, këto dokumente njohin masat e aksionit afirmativ ndaj grupeve statusi i të cilëve është i pavolitshëm ose të drejtat e tyre janë të dëmtuara në mënyrë permanente. Intenca e Ligjdhënësit që grupeve të pakicave, të cilat gjenden në pozitë të pavolitshme, i mundëson kushte të volitshme për tejklimin e gjendjes së tillë, gjendet në nenin 4. të Ligjit, titulli i të cilit është Masat për sigurimin e barazisë.

Liritë e shprehjes dhe përcaktimit nacional

Në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, neni 5. alinea 1. është proklamuar që askush nuk guxon të pësojë dëm përshkak të përkatësisë së vet nacionale dhe shprehjes së përkatësisë nacionale ose për shkak të përmbajtjes nga një gjendje e tillë.

Kushtetuta e Serbisë në nenin 49. precizon që qytetarit i jipet e drejta e shprehjes së lirë për përkatësinë nacionale dhe kulturore... „Nga këto burime Karta për të drejtat e njeriut dhe të pakicave nxjerr argumentin i cili sipas përmbajtjes është nën liritë dhe të drejtat e definuara më parë në dokumentet e përmendura: „ Jipet liria e shprehjes së përkatësisë nacionale. Askush nuk është i obliguar të japë sqarime për përkatësinë e vet nacionale“ (neni 48.).

Në pikëpamje të lirisë së përcaktimit dhe shprehjes së identitetit nacional (përkatësisë) Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale e cila përkundër dëshirës së tyre i obligon që të shprehen për përkatësinë e tyre nacionale“ (alinea 2. neni 5), si dhe ndalimin e „çdo veprimi dhe masa të dhunshme të asimilimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale“ (alinea 3.e këtij ligji).

Bashkëpunimi i pakicave me shtetet amë

Neni 6. i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale i jep pjesëtarëve të pakicave nacionale të drejtë që „lirisht të themelojnë dhe mirëmbajnë marrëdhënie paqësore“, si brenda bashkësisë shtetërore ashtu edhe me bashkëatdhetarët në diasporë. Baza dhe burimi i këtij formulimi është në nenin 17. të Konventës kornizë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale nga është marrë formulimi i përmendur.

Obligimet e pakicave nacionale

Në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, obligimet e pakicave nacionale janë definuar në kuptimin e respektimit të përmbajtjes së Kushtetutës, parimet e të drejtës ndërnacionale dhe moralit publik, që në praktikë duhet të kuptohet për të gjitha veprimet e drejtuara kah thyerja e dhunshme e kushtetutës, thyerja e tërësisë territoriale të vendit, thyerja e të drejtave të dhëna të njeriut dhe të qytetarëve dhe nxitjes së mosdurimit rasor dhe religjioz dhe urrejtjes (neni 7.).

Të drejtat e fituara

Neni 8. i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale e fut në praktikën tonë kushtetuto-ligjore institucionin e të drejtave të fituara, sipas së cilit pjesëtarëve të pakicave nacionale nuk mund t’u hiqen të drejtat të cilat iu janë njohur me kontrata ndërnacionale, të cilat shteti i ka nënshkruar deri atëherë dhe me rregulla të rëndësishme ndër-ligjore.

Ky përcaktim është vërtetuar me formulim të njëjtë që është forcuar me alinenë e nenit 57. në të cilin thotë: „Fitimi i nivelit të të drejtave të nejrut dhe të pakicave nuk mund të zvogëlohet“.

Të drejtat kolektive

Një pjesë e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale– „ të drejtat për ruajtjen e veçorive“ përmban të drejta të cilat kryesisht kanë qenë të përmbajtura në vendimet e mëhershme **kushtetuto-ligjore**, por në mënyrë tjetër më kualitative.

Por, edhe pse në këtë vend të drejtat, me të cilat rregullohet mbrojtja e veçorive të pakicave nacionale, lidhet për individë, padyshim është fjala për të drejtat që kanë të bëjnë me bashkësitë e pakicave. Në lidhje me këtë duhet përmendur që marrëdhënia ndaj të drejtave kolektive e përcaktuar në fillim të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave, në nenin 1. me të cilin shprehen qëllimet dhe idetë e veta themelore: „Me këtë Ligj rregullohet mënyra e realizimit të të drejtave individuale dhe kolektive të cilat iu janë garantuar pjesëtarëve të pakicave me Kushtetutën e RFJ-së ose me marrëveshje ndërnacionale“. Edhe më tej në alinenë 2. të këtij neni: „me këtë nen... vendosen instrumentet me të cilat sigurohen dhe mbrohen të drejtat e veçanta të pakicave nacionale për vetqeverisje në lëminë e arsimimit, përdorimit të gjuhës, informimit, kulturës...“

Në Kartën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve, neni 47 është precizuar që „pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë individuale dhe kolektive, të drejta të cilat i realizojnë individualisht ose në bashkësi me të tjerët, në harmoni me ligjin dhe standardet ndërnacionale“.

Karta, janë të lidhura për kulturën e tyre, arsimimin, informimin dhe përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, në pajtim me ligjin“.

Pra është e padyshimtë që në praktikë të futen dy kategori të cilat deri atëherë nuk kanë qenë të njohura në sistemin tonë ligjor– të drejtat kolektive të pakicave nacionale dhe e drejta në vetqeverisje. Të drejtat kolektive që iu njihen pakicave në sferën e autonomisë kulturore nuk janë ndonjë privilegj dhe asgjë që

pjesëtarët e shumicës nuk janë duke realizuar. Fjala është për të drejtat univerzale të cilat duhet tju jipen të gjithëve dhe të gjithë të kenë qasje në to.

Autonomia kulturore

E drejta për autonominë kulturore të pakicave nacionale është rregulluar me nenet 9, deri 17, të Ligjit për mbrojtjen e pakicave nacionale. Këto të drejta kanë të bëjnë me veçoritë etnokulturore të pjesëtarëve të pakicave nacionale, respektivisht me afirmimin e të drejtave të tyre gjuhësore dhe kulturore.

Në Kartën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe liritë e qytetarëve është e qartë që fjala është për „ të drejtat në ruajtjen e veçorive“, të cilat kanë të bëjnë me: shprehjen publike të veçorive nacionale dhe etnike, kulturore dhe religjioze, në përdorimin e lirë të gjuhës dhe shkrimit të tyre; me atë që në rrethet me numër të madh të popullatës pakicë organet shtetërore të udhëheqin procedurën edhe në gjuhën e pakicave nacionale, e cila përbën pjesën më të madhe të popullatës; me shkollimin në gjuhën e vet; me atë që emrin dhe mbiemrin e vet ta përdorin në gjuhën e vet, duke përfshirë edhe të drejtën e shprehjes, pranimit, dërgimit dhe shkëmbimit të informatave dhe ideve.

Autonomia kulturore e pakicave nacionale në Ligjin për pakicat fillon me të drejtën e pjesëtarëve të pakicave nacionale në zgjedhjen e lirë dhe përdorimin e emrit të vet dhe emrave të fëmijëve të tyre si dhe shënimin e këtyre emrave në dokumentacionet personale, evidentime zyrtare dhe dosie— në gjuhën dhe drejtshkrimin e pjesëtarëve të pakicave nacionale (neni 9).

Përdorimi zyrtar i shkrimit dhe gjuhës

Me ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale është paraparë që, pjesëtarët e pakicave nacionale

munden lirisht, në jetën private dhe publike të përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre. Në nenin 10. është precizuar e drejta kolektive që në njësitë e vetqeverisjes lokale, në të cilat pjesëtarët e pakicës së caktuar tradicionalisht të vendosur, në përdorim zyrtar mund të jetë edhe gjuha e pakicës nacionale. Alinea tjetër e këtij neni të Ligjit obligon njësitë e vetqeverisjes lokale në të cilat jeton më shumë se 15% e popullatës pakicë të mundësojnë përdorim të barabartë të gjuhës së pakicës nacionale në përdorim zyrtar—në procedurë gjyqësore dhe administrative, në komunikim me organet administrative me qytetarët, dhënien e dokumentacionit personal të plotëfuqishëm të qytetarëve në gjuhën e tyre amtare, në listat zgjedhore dhe punën e trupave prezantues.

Neni i njejtë më tej përcakton mënyrën e shprehjes së shenjave në gjuhën e pakicave, e mbështetet në Kushtetutën e atëhershme të RF të Jugosllavisë, sipas së cilës në përdorim zyrtar në organet e administratës federale kanë qenë gjuhët e pakicave nacionale të cilat sipas regjistrimit të fundit të popullatës përbënin 2% nga numri i përgjithshëm i popullatës në vend. Në pajtim me institucionin e të drejtave të fituara obligimi i njejtë duhet të aplikohet edhe në të ardhmen.

Në lidhje me të drejtat e fituara, e duke pasur parasysh trendin e shprehur depopullues në mesin e popullatës së pakicave tradicionale në Vojvodinë, në të cilat gjuha e pakicës nacionale ka qenë në përdorim në momentin kur është aprovuar ligji, e në popullatën e përgjithshme të bashkësisë nuk kanë pasur 15% të popullatës, ajo gjuhë të mbetet në përdorim zyrtar.

Ruajtja e identitetit etnokulturorë

Në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave, me nenin 12, si e drejtë individuale dhe kolektive e pakicave nacioanle është përcaktuar e drejta në shprehje, ruajtje, kultivim, zhvillim, bartje dhe shprehje publike e veçorisë nacionale, etnike, kulturore,

religjioze dhe gjuhësore. Realizimi i këtyre të drejtave iu është besuar bashkësive të pakicave të cilat mund të themelojnë shoqata, institucione dhe fondacione të specializuara, qëllimet e punës së të cilave iu janë dedikuar mbrojtjes së identitetit etnokulturor të pakicave dhe shtetit, i cili sipas mundësive merr pjesë në financimin e punës së këtyre institucioneve, por edhe përmes institucioneve, themelues i të cilëve është (arkivi, institucionet për mbrojtjen e monumenteve kulturore, muzetë) mundëson përfaqësimin e trashëgimisë kulturoro-historike të pakicave nacionale. Ndikimi i pakicave në përfaqësimin e kulturës dhe traditës së tyre është siguruar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këshilleve nacionale në procesin e vendimmarrjes për përfaqësimin e pakicave nacionale.

E drejta për shkollim në gjuhën amtare

E drejta për shkollim e pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në gjuhën e vet amtare bie në grupin e të drejtave të cilat pa dyshim i takojnë bashkësisë së pakicave. E drejta individuale e qytetarit në shkollim është vetëm bazë e të drejtës kolektive e cila del nga dëshira e qytetarëve që të shkollohen në gjuhën amtare. Të përmendet neni 52. i Kartës për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe lirive të qytetarëve precizon që pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë shkollimi në gjuhën e vet në institucionet shtetërore, si dhe në themelimin e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve.

Në Kushtetutën e Serbisë iu është dhënë e drejta pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive për shkollim në gjuhën amtare.¹⁸

Në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, në nenin 13, shprehimisht thuhet që: „ pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë në edukim dhe shkollim në gjuhën e vet në institucionet parashkollore, të shkollimit fillor

18 Kushtetuta e Serbisë, neni 32.

dhe të mesëm“, si dhe që shteti është i obliguar të krijojë kushte për organizimin e shkollimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale ose të sigurojë mësimdhënie dygjuhësore ose mësimin e gjuhës së pakicës nacionale me elemente të kulturës dhe historisë nacionale.

Në alinenë tjetër të këtij neni udhëzohet për institucionin e diskriminimit pozitiv (neni 4. i këtij Ligji), në kuptimin që numri i nxënësve për të cilët organizohet mësimi në gjuhën amtare mund të jetë më i vogël se numri i nxënësve që është përcaktuar me ligj, për sigurimin e formave të duhura të mësimin dhe shkollimit.

përveç arsimimit të obliguar fillor, mësimi në gjuhët e pakicave nacionale organizohet edhe në nivelin e shkollimit të mesëm dhe të lartë. Këto lloje të institucioneve arsimore, në pajtim me Ligjin mund të themelojnë organizata të pakicave nacionale dhe personave privat, e në finansimin e tyre mund të marrin pjesë organizatat vendore dhe të huaja, fondacione dhe persona privat, përderisa shteti është i obliguar të lirojë nga obligimet tatimore mjetet finansiare të siguruara nga donacionet ëpr këtë qëllim.¹⁹

Për nevoja të shkollimit në gjuhët e pakicave nacionale, mësuesit, arsimtarët dhe edukatorët, si dhe arsimtarët e gjuhës së pakicave nacionale, shkollohen në institucione të shkollimit të lartë në gjuhën amtare. Në bazë të shkollimit universitar të cilin e organizon shteti, në disa fakultete formohen lektorate në gjuhët e pakicave nacionale që duhet të kenë dobi në atë që studentët-pjesëtarët e pakicave nacionale, të mbizotërojnë terminologjinë profesionale në gjuhën amtare.²⁰

Ligji ka përcaktuar që pjesëtarët e këshilleve nacionale, si trupa të vetqeverisjes të marrin pjesë në hartimin e planeve mësimore për të gjitha nivelet dhe format e mësimin të pakicave nacionale,

19 Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale në RFJ, neni 15.

20 Ibid, neni 14.

si dhe atë që diplomat e fituara në vende të huaja, respektivisht në shtetet amë të njihen sipas procedurës së duhur ligjore.

Një hap drejt multietnicitetit integrues ligjdhënësi e ka bërë duke përcaktuar obligimet e pjesëtarëve të pakicave nacionale të mësojnë gjuhën serbe, si dhe me alinenë e fundit të nenit 13,- në të cilin përcaktohet modeli i dëshiruar i shkollimit në shoqërinë multietnike dhe multikulturore. Ky nen thotë: „Plani dhe programi i punës në institucionet arsimore dhe shkollat me mësim në gjuhën serbe, me qëllim të arritjes së tolerancës ndaj pakicave nacionale, duhet të përmbajë pjesë që përmbajnë dituri për historinë, kulturën dhe pozitën e pakicave nacionale, si dhe përmbajtje të tjera që avancojnë tolerancën e ndërsjellë dhe bashkëjetesën. Në territoret ku gjuha e pakicës nacionale është në përdorim zyrtar, planpakicave nacionale“.

E drejta për informim në gjuhën amtare

Me nenin 17 të Ligjit është paraparë që pakicat kanë të drejtë në informim të plotë dhe të pakushtëzuar në gjuhën e vet, e cila nënkupton edhe të drejtën në shprehje, pranim, dërgim dhe shkëmbim të informatave dhe ideve përmes shtypit dhe mjeteve tjera të informimit.

Përveç asaj që pakicat në mënyrë të pavarur mund të themelojnë mediat e veta, Ligji parasheh obligimin e shtetit që në programet e radios, televizionit dhe shërbimit publik të sigurojë përmbajtje informative, kulturore dhe arsimore në gjuhën e paikcave nacionale.

Kushtetuta e Serbisë nuk merret me imtësi të problemeve të informimit në gjuhën e pakicave nacionale, por me nenin 46. qytetarëve parimisht i jep lirinë e shtypit dhe pikëpamjeve tjera të informimit publik.

Përdorimi i simboleve nacionale

Në Kartën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe lirive të qytetarëve është shprehur e drejta e pjesëtarëve të pakicave nacionale të përdorin simbolet e veta në vendet publike.

Në Kushtetutën e Serbisë nuk përcaktohet mënyra e përdorimit të simboleve të pakicave nacionale, por në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale iu është njohur pjesëtarëve të pakicave nacionale e drejta në zgjedhje dhe përdorim të simboleve nacionale dhe shenjave të cilat nuk guxojnë të jenë identike me shenjat e të tjerëve, respektivisht me ato të shteteve amë.

Me Ligj është paraparë që me simbolet dhe shenjat e pakicave nacionale, të cilat mund të shprehen gjatë festave shtetërore dhe festave të pakicave nacionale në vendet publike dhe institucione me autorizim publik— në vendet në të cilat gjuha e pakicave nacionale është në përdorim zyrtarë, gjithsesi të shprehen edhe shenjat e anëtares shtetërore.

Pjesëmarrja aktive e pjesëtarëve të pakicavenacionale në vendimmarrje për çështjet e veçorive në pushtet dhe administratë

Mbështetje kryesore e pjesëmarrjes aktive të pakicave nacionale në vendimmarrje për mbrojtjen e veçorive të tyre është e drejta në vetqeverisje, e cila realizohet përmes institucioneve të këshilleve nacionale të pakicave.²¹ Këshillet nacionale formohen për shkak të realizimit të së drejtës për vetqeverisje në lëminë e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit, shkollimit, informimit dhe kulturës, dhe si të tilla marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes

21 Neni 19. i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale.

ose vendosin për çështjet nga ato lëmi dhe themelojnë institucione të duhura.

Organet e shtetit ose vetqeverisjes territoriale ose lokale janë të obliguar, që kur të marrin vendime në lidhje me çështjet e përmendura, të kërkojnë mendimin e këshillit nacional të pakicës nacionale të caktuar. Gjithashtu, pjesë e punës në lidhje me aktivitetet e përmendura mund t'iu besohet këshilleve nacionale të pakicave nacionale, e shteti siguron mjete për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Pjesëmarrja aktive e pakicave në jetën politike realizohet në njësitë e vetqeverisjes lokale në të cilat pakicat nacionale kanë pjesëmarrje të madhe në numrin e përgjithshëm të popullatës. Në këto komuna pjesëtarët e pakicave nacionale në pajtim me rregullat e përgjithshme të cilat vlejné me rastin e zgjedhjes së këshilltarëve në njësitë e vetqeverisjes lokale, mund të theksojnë kandidatë dhe lista të kandidatëve dhe të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në kuvendet komunale. Indirekt, pjesëtarët e pakicave nacionale në jetën politike të komunave marrin pjesë edhe si këshilltarë të zgjedhur nga lista të partive tjera politike.

Në zgjedhjet për këshilltarë në Kuvendin e KA të Vojvodinës, që janë mbajtur në Shtator të vitit 2004, për herë të parë në disa zgjedhje të Serbisë janë aplikuar masat e aksionit afirmativ sipas partive politike të pakicave nacionale.

Në të vërtetë, zgjedhjet janë mbajtur sipas zgjedhjes së kombinuar të sistemit zgjedhor, pa census politik të partive të pakicave nacionale, e për ato është i zvogëluar edhe numri i nënshkrimeve që duhet dorëzuar me listën zgjedhore prej 6.000 në 3.000. Por, sukses në zgjedhje kanë realizuar pjesëtarët e pakicës nacionale hungareze, partitë politike të së cilëve kanë fituar 6 këshilltarë nga lista proporcionale dhe 5 nga lista e shumicës.

Të drejtat e pakicave nacionale në vetqeverisjet lokale

Me Ligjin për vetqeverisjen lokale është paraparë²² që njësitë e vetqeverisjes lokale, në mes të kompetencave të tyre burimore, kanë obligim të kujdesen „për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave personale dhe kolektive të pakicave nacionale dhe grupeve etnike“ (neni 18, pika 28) dhe „të përcatojnë gjuhët dhe shkrimin e pakicave nacionale që janë në përdorim zyrtar në territorin e e komunës“ (neni 18, pika 29).

në praktikë kjo do të thotë që kompetencat e njësisve të vetqeverisjes lokale në lidhje me të drejtat e pakicave nacionale kanë të bëjnë me themelimin dhe punën e institucioneve dhe organizatave në lëminë e shkollimit, mbrojtjes së të mirave kulturore, punës së bibliotekës, muzeve dhe institucioneve tjera kulturore, sigurimi i informimit publik, futja e gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në komunikimin publik etj.

Kompetenca komunale të tilla burimore, të formuluar nënkuptojnë që njësitë e vetqeverisjes lokale në Serbi duhet të sigurojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale të garantuara me sistemin e të drejtës kushtetuese të vendit. Në praktikë kjo do të thotë që njësitë e vetqeverisjes lokale duhet të sigurojnë kushte për realizimin e mbrojtjes së të drejtave edhe për ruajtjen dhe avancimin e identitetit të pakicave nacionale të cilat janë të vendosura në territorin saj.

Edhe pse me ligj bazik në këtë lëmi— me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale është paraparë që të mbrohen identitetet e bashkësive nacionale dhe që kriteriumi inumrit në lidhje me këtë nuk ka ndonjë kuptim të rëndësishëm në bazë të së cilëve njësitë e vetqeverisjes lokale janë të obliguara të ndër marrin aktivitete në lidhje me kompetencat e veta burimore.

22 „Gazeta zyrtare RS“, nr. 9/2002, 33/2004.

Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale përcakton obligimin e komunave në të cilat jeton 15% e popullatës e cila i takon një pakice nacionale, të fusin në përdorim gjuhën e asaj pakice. Me Ligjin për shkollimin fillor gjithashtu janë përcaktuar kushtet në pikëpamje të numrit të nxënësve për të cilët organizohet ndonjë aspekt i mësimi në gjuhët e pakicave nacionale.

E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës është një nga të drejtat elementare të cilat pakicat nacionale e realizojnë në lidhje me ruajtjen e identitetit të vet. Problemet në lidhje me implementimin e të drejtave të pakicave për përdorim zyrtar të gjuhës janë të dukshme, dhe sipas rregullave nxisin tensione dhe trazira në marrëdhëniet ndërnacionale. Realizimi i kësaj të drejte iu është besuar njërive të vetqeverisjes lokale si kompetencë e tyre burimore.

Përdorimi zyrtar i gjuhës është precizuar me zligjin për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të Republikës së Serbisë. „Në vendet e Republikës së Serbisë në të cilat jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar ende kanë gjuhën serbe dhe gjuhën dhe shkrimin e kombësive, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj“, kurse në KA të Vojvodinës edhe me statutin e e krahinës autonome me të cilin organet krahinore obligohen të „sigurojnë përdorim zyrtar njëkohësisht me gjuhët serbokroate dhe hungareze, sllovaqe, rumune dhe rusine si dhe shkrimit të tyre të kombësive tjera në mënyrë të përcaktuar me ligj“.²³

Njërive të vetqeverisjes lokale iu është lënë mundësia që, në vendet ku dominojnë pakicat nacionale në strukturën e popullatës, me statut të rregullojnë përdorimin e gjuhës së kombësisë.

Në harmoni me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit, kur në përdorim zyrtar është gjuha e pakicës nacionale, teksti në këtë

23 Statuti KA të Vojvodinës, neni 10. alinea 4. „Gazeta zyrtre KAV“, nr. 17/1991.

gjuhë shënohet nën tekstin në gjuhën serbe ose në anën e djathtë të tij, në formën dhe shkronjat e njëjta.

Me nenin 7. të ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit është përcaktuar që emrat gjeografik dhe emrat e përveçëm në shënimet publike nuk mund të zëvendësohen me emra tjerë, dhe duhet të shënohen në gjuhën e pakicave, në pajtim me drejtshkrimin e asaj gjuhe.

Me nenin 12. të Ligjit është përcaktuar që organet e shkallës së parë të administratës, penale, procedurale ose ndonjë veprimtari tjetër të udhëhiqet në gjuhën serbe, por mund të udhëhiqet edhe në gjuhën e pakicës që është në përdorim zyrtar. Nëse institucioni i cili e udhëheq procedurën është kompetent për më shumë komuna nacionalisht heterogjene, procedura mund të udhëhiqet në gjuhët amtare për pjesëtarët e pakicave që kanë vendbanim të përhershëm në territorin e komunës.

Në vendet ku gjuhët e pakicave nuk janë në përdorim zyrtar të institucionit, të cilat janë kompetente për udhëheqjen e procedurës, janë të obliguara që pjesëtarëve të pakicave t'i lejojnë përdorimin e gjuhës amtare dhe shkrimin, që në atë gjuhë të bëjnë lutje, ankesa, kërkesa dhe propozime, si dhe në atë gjuhë t'iu dorëzohen aktet ligjore dhe aktet tjera administrative.

Në komunat në të cilat gjuhët e pakicave janë në përdorim zyrtar, me kërkesë të pjesëtarëve të pakicave, në gjuhën amtare jipen dëftesat për arsimimin e arritur, si dhe dokumentet tjera publike. Në këto komuna evidenca e përcaktuar udhëhiqet edhe në gjuhët e pakicave, e formularët shtypen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës që është në përdorim zyrtar (neni 18).

Përparim të dukshëm paraqet Vendimi i Kuvendit të Krahinës Autonome të Vojvodinës për rregullimin e afërm të çështjeve të caktuara të përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në territorin e KA të Vojvodinës, e aprovuar më 15 Maj të vitit 2003.

Me vendim në mënyrë më precize rregullohen çështjet e vecanta të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në territorin e KA të Vojvodinës: mënyra e realizimit të përdorimit zyrtar të barabartë të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në punën e organeve të Krahinës, organeve dhe organizatave të njësisve të vetqeverisjes lokale, në njësitë organizative të organeve të administratës shtetërore, ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe shërbimeve të themeluara për gjithë territorin e Republikës së Serbisë, selia e të cilëve gjendet në territorin e Krahinës; e drejta në zgjedhje dhe përdorim të emrit personal të pakicave nacionale, si dhe në dhënien e dokumentacionit publik dhe dokumenteve tjera që janë me interes për realizimin e të drejtave të qytetarëve, të përcaktuara me ligj; përdorimi i gjuhës në lëminë e ekonomisë dhe shërbimeve, shënimi i emrave të vendeve, emrave tjerë gjeografik, emrat e shesheve dhe rrugëve, emrat e organeve, organizatave dhe firmave, lajmërimi i thirrjeve publike, lajmërimet dhe vërejtje për publik, si dhe shkrimi i emrave tjerë publik; kushtet për futjen e përdorimit të barabartë të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në njësitë e vetqeverisjes lokale; dërgimi i raporteve Kuvendit të KA të Vojvodinës për realizimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale, etj.

Kuvendi i KA të Vojvodinës ka aprovuar vendimin për formularë shumëgjuhësorë të certifikatave të librave amë dhe për mënyrën e regjistrimit në të njejtat,²⁴ në bazë të së cilës formularët për regjistrim në librin amë shtypen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës. Në librat amë teksti në gjuhën e pakicës shënohet në formularë nën tekstin e gjuhës serbe, e certifikatat nga librat amë jipen në dy gjuhë.

Obligimet e njësisve të vetqeverisjes lokale në lidhje me realizimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave janë të parapara edhe me nenin 60. të Ligjit për zgjedhjen e

24 „Gazeta zyrtare e KA të Vojvodinës“, nr.1/2001 dhe 8/2003.

deputetëve nacionale, me të cilin është përcaktuar që në „komunat ku në përdorim zyrtarë janë gjuhët e pakicave nacionale, listat votuese të shtypen edhe në ato gjuhë. Më në fund, me nenin 100. të këtij Ligji është i autorizuar këshilli mbikqyrës për kampanjën zgjedhore që përpara organeve shtetërore të inicojë fillimin e procedurës kundër personave të cilët gjatë kampanjës zgjedhore me sjelljet e veta kanë thirrur për dhunë ose zgjerim të urrejtjes nacionale ose fetare.

Në lidhje me këto kompetenca njësia e vetqeverisjes lokale duhet përmendur edhe atë që ato realizohen në mënyrë të ndryshme në vendet e ndryshme të Serbisë. Standarde të larta janë realizuar në Vojvodinë, në njësitë e vetqeverisjes lokale të së cilave të drejtat e caktuara, që janë kushtëzuar me potencialin e numrit të bashkësisë nacionale demografikisht janë nën minimumin e caktuar me ligj.

Gjuhët dhe skrimet të cilat përveç gjuhës serbe dhe shkrimit qirilik janë në përdorim zyrtar në vetqeverisjet lokale në KA të Vojvodinës:

1.	Ada	hungarisht
2.	Alibunari	rumunisht dhe sllovakisht
3.	Apatini	hungarisht dhe sllovakisht
4.	Baçi	hungarisht dhe sllovakisht
5.	Baçka Pallanka	sllovakisht
6.	Baçka Topolla	hungarisht, gjuha rusine dhe sllovaqe
7.	Baçki Petrovac	sllovakisht
8.	Bela Crkva	hungarisht, rumunisht, çekisht
9.	Beoçin	sllovakisht

10.	Beçej	hungarisht
11.	Vrbas	hungarisht dhe gjuha rusine
12.	Vrshac	rumunisht dhe hungarisht
13.	Zhabalj	gjuha rusine
14.	Zhitishte	hungarisht, rumunisht
15.	Zrenjanin	hungarisht, rumunisht, sllovakisht
16.	Kanjizha	hungarisht
17.	Kikinda	hungarisht
18.	Kovacica	sllovakisht, hungarisht, rumunisht
19.	Kovin	hungarisht, rumunisht
20.	Kula	gjuha rusine dhe hungareze
21.	Malli Igjosh	hungarisht
22.	Nova Crnja	hungarisht
23.	Novi Beçej	hungarisht
24.	Novi Knezhevac	hungarisht
25.	Novi Sad (qyteti)	hungarisht, sllovakisht, rumunisht, gjuha rusine
26.	Oxhaci	hungarisht, sllovakisht
27.	Plandishte	hungarisht, sllovakisht, rumunisht
28.	Senta	hungarisht
29.	Seçanj	hungarisht, rumunisht
30.	Sombor	hungarisht
31.	Srbobran	hungarisht
32.	Stara Pazova	sllovakisht

33.	Subotica	hungarisht, kroatisht
34.	Temerin	hungarisht
35.	Titel	hungarisht
36.	Çoka	hungarisht
37.	Shid	gjuha sllovake dhe rusine

Në vendet tjera të Serbisë ekzistojnë probleme në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave nacionale. Në komunat e Sanxhakut shumë ngadalë dhe me kundërshtime të shumëta të popullatës shumicë në institucionet e tyre realizohen të drejtat e garantuara me ligj për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, shkollimit, mbrojtjes së të mirave kulturore. Ky tension është i dukshëm në faktin se në komunat Novi Pazar, Tutin dhe Sjenicë, në të cilat pushtetin lokal e realizojnë partitë politike boshnjake, kanë marrë vendim për përdorimin zyrtar të gjuhës boshnjake, por këtë ende nuk e kanë bërë Prijepolje dhe Priboj të cilat nëse në mëyrë strikte e respektojnë Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirve të pakicave nacionale, Ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit dhe Ligjin për vetqeverisjen lokale, duhet ta bëjnë këtë.

Në lidhje me realizimin e të drejtave për shkollim në gjuhën e pakicave nacionale njësitë e vetqeverisjes lokale kanë kompetenca të rëndësishme që rrjedhin nga Ligji për themelet e arsimit dhe edukimit.²⁵ Përveç dispozitave të përgjithshme²⁵ për qasjen e njejtë në arsimim për të gjithë qytetarët, zhvillimin e kulturës dhe traditës së pakicave nacionale, ndalimin e diskriminimit të nxënësve në bazë të rasës, përkatësisë nacionale ose etnike, të

25 Ligji është publikuar në 'Fletoren zyrtare të RS të Serbisë', nr. 62/2003 dhe 64/2003), e ka hyrë në fuqi më 25 Maj të vitit 2003. Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për themelet e sistemit të arsimit dhe edukimit e publikuar në „Fletoren zyrtare të RS“, nr. 58/04 dhe 62/04 nga 28. Maji 2004. e ka hyrë në fuqi më 5 Qershor të viti 2004.

drejtat e pakicave nacionale që mësimin ta zhvillojnë pjesërisht ose plotësisht në gjuhën amtare dhe të drejtat e këshilleve nacionale për pakicat nacionale të propozojnë një kandidat për Këshillin nacional për arsimim, janë paraparë edhe kompetenca konkrete dhe obligime të vetqeverisjeve lokale në arsimimin në bashkësitë lokale. Njësia e vetqeverisjes lokale mundet të themelojë institucion parashkollor, të shkollës fillore dhe të mesme, si dhe me aktin për rrjetin e institucioneve të planifikojë numrin dhe renditjen ambientale të institucionit. Aktin për rrjetin e çerdheve të fëmijëve dhe shkollave fillore e bie kuvendi i komunës në bazë të kriteriumeve që i cakton Qeveria, e pëlqimin për rrjetin e shkollave fillore e bie Ministria e arsimit dhe sportit e Republikës së Serbisë. Përveç kësaj vetqeverisja lokale mundet që me pëlqimin e Ministrisë të organizojë që institucioni arsimor të kryej aktivitete në hapësirë të ndarë nga selia e vet.

Në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave nacionale, për arsimim në gjuhën amtare është e rëndësishme kompetenca e njësive të vetqeverisjes lokale në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e organeve të administratës së institucionit arsimor në të cilën një të tretën e anëtarëve e propozon njësia e vetqeverisjes lokale.

Më në fund, njësia e vetqeverisjes lokale është e obliguar të marrë pjesë në financimin e aktiviteteve të institucioneve, themelues i të cilëve është. Sistemi i zhvilluar i arsimimit në gjuhën e pakicave nacionale realizohet në KA të Vojvodinës, ku ky lloj i arsimit, në pajtim me kushtet e caktuara me ligj, organizohet në tërësi në gjuhën e pakicave nacionale, në dy gjuhë dhe me mësimin e lëndëve të Gjuhës amtare me elemente të kulturës nacionale. Në tetë shkolla fillore mësimi organizohet kryesisht në gjuhën hungareze, në pesë shkolla në gjuhën sllovaqe, në katër shkolla në gjuhën rumune dhe në një shkollë në gjuhën rusine. Në 92 shkolla fillore mësimi organizohet në dy gjuhë (27%) e

në gjashtë shkolla në tri gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhët e pakicave nacionale.

Mësimi në gjuhët e pakicave nacionale në shkollat e mesme organizohet në bazë të Ligjit për shkollimin e mesëm dhe Ligjit për themelet e sistemit të edukimit dhe arsimimit sipas së cilit ky lloj i mësimdhënies organizohet nëse për këtë deklarohen 15 nxënës në klasën e parë.

Në KA të Vojvodinës kjo e drejtë mund të njihet edhe me numër më të vogël të nxënësve nëse arrihet pëlqimi nga sekretari krahinor për arsimim dhe kulturë. Në shkollat e mesme të Vojvodinës mësimi organizohet edhe në gjuhët hungareze, sllovae, rumune dhe rusine. Në gjuhët e pakicave nacionale mësimi organizohet në 17 nëjsi të vetqeverisjes lokale, respektivisht në 39 shkolla të mesme, nga cilat 14 janë gjimnaze, 24 drejtime profesionale dhe një shkollë e artit.

Por, në disa vende të Serbisë dhe në më shumë njësi të vetqeverisjes lokale nuk realizohen masat e caktuara me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave kolektive të pakicave. Arsyet për një gjendje të tillë janë të ndryshme. Në disa komuna nuk ekziston interesim i qytetarëve, pjesëtarë të pakicave nacionale të shfrytëzojnë disa nga të drejtat të cilat iu takojnë. Për të mos u futur në arsyet dhe motivet e pjesëtarëve të pakicave nacionale që të mos realizojnë disa nga të drejtat kolektive, duhet konstatuar që kjo është legjitime nëse vendimi është marrë me dëshirën e lirë të qytetarëve pa ndikimin dhe pa tension të shumicës lokale. në komunat tjera ekziston rezistenca e shumicës që të njohin të drejtat e pjesëtarëve të pakicave nacionale sepse tendencat e tilla i konsiderojnë si dezintegrative si në pikëpamjen e bashkimit të bashkësisë së gjerë shoqërore, ashtu edhe në marrëdhënien e korpusit nacionale Serb.

Në vetqeverisjet lokale të tilla mungojnë programe të edukimit të qytetarëve për vlerat e multikulturalizmit integrues dhe gjithsesi mungon dituria e pushteteve komunale për menaxhim në rrethet

multietnike. Më në fund aplikimi strikt i ligjit në disa vende mundet që të kushtëzojë edhe ashpërsimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe të destabilizojë gjendjen në regjion. Në rastet e tilla duhet që patjetër të ndërmerren aktivitete në lidhje me sensibilizimin e qytetarëve për tejkalimin e animoziteteve dhe ballafaqimin me ndodhitë nga e kaluara. Pra, në njësitë e vetqeverisjes lokale, sipas ligjeve prezente, pakicat nacionale duhet të realizojnë shumicën e të drejtave të cilat kanë të bëjnë me kulturën e tyre, autonominë–arsimin, informimin, përdorimin e gjuhës amtare në komunikimin publik, mbrojtjen dhe avancimin e identitetit kulturorë.

Për disa nga këto të drejta njësitë e vetqeverisjes lokale vendosin vetë dhe për këtë sine qua non realizimi i të drejtave të pakicave dhe themeli i zhvillimit të demokracisë lokale, njohja e intereseve të bashkësisë lokale, kyçja e pakicave nacionale si bashkësi në atë proces. Zhvillimi i mekanizmave që pakica lokale të marrë pjesë aktive në definimin e nevojave të veta dhe të ndikojë në realizimin e hapit të ardhshëm drejt themelimit së realizimit të të drejtave, ashtu edhe arritjes së marrëdhënieve stabile ndëretnike.

Pikërisht për këtë nuk duhet të lajmërohen shembuj të praktikës së keqe në ato segmente të mbrojtjes së të drejtave të pakicave nacionale të cilat njësitë e vetqeverisjes lokale duhet ti implementojnë në bazë të burimeve të veta, pra të kompetencave direkte.

Në lidhje me këtë duhet përmendur edhe disa nene të Ligjit për vetqeverisjen lokale të cilat komunave i lënë mjaft hapësirë për rregullimin e çështjeve në këtë lëmi, por edhe parashohin mekanizma të caktuar korrekтив në kuptim të dëmtimit të të drejtave në lidhje me barazinë nacionale ose fetare. Njësitë e vetqeverisjes lokale, në mënyrë të pavarur, por edhe me pëlqimin e organeve kompetente të administratës shtetërore, bien statute dhe akte të tjera me të cilat përcaktohen simbolet, festat, emrat e rrugëve, shesheve dhe pjesëve të banuara, e nëse përmbajtja e

dispozitave të statutit ose akteve të tjera të përmendura nuk iu përgjigjet fakteve historike ose reale, ose nëse atyre iu dëmtohen ndjenjat fetare ose nacionale, ministria për vetqeverisje lokale është e obliguar që në afat prej 30 ditëve nga pranimi i statutit ose të dokumentit të pajtohet me atë ose jo.²⁶

më tej, në bazë të Ligjit për vetqeverisje lokale, të gjithë qytetarëve, si dhe pakicave nacionale iu është e mundur që mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të veta ta iniciojnë me angazhim direkt, përmes „iniciativës së qytetarëve, tubim të qytetarëve dhe referendum“ (neni 65).

Gjithashtu, me nenin 126. të Ligjit është paraparë që në njësitë e vetqeverisjes lokale themelimi i mbrojtësit të qytetarëve, ombudsmanit, funksioni i të cilit është të „mbrojtë të drejtat individuale dhe kolektive dhe intereset e qytetarëve, ashtu që bën kontroll të përgjithshëm të punës së administratës dhe shërbimeve publike“ (neni 126). Institucioni i ombudsmanit në Serbi është themeluar me Ligjin për mbrojtësin e qytetarëve, e u implementua me themelimin e ombudsmanit në Vojvodinë. Sipas ligjit për mbrojtësin e qytetarëve ky institucion është definuar si „organ i pavarur shtetëror i cili i mbron të drejtat e qytetarëve dhe kontrollon punën e organeve të administratës shtetërore...“

Në lidhje me këtë, e veçanërisht në lidhje me punën e këshilleve komunale për marrëdhënie ndërnacionale është me rëndësi të përmendet që në mesin e organizimit dhe strukturës së punës së mbrojtësit republikan të qytetarëve, vend me rëndësi zënë punët në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale. Përveç kësaj duhet përmendur që në pajtim me Kartën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave nacionale dhe të lirive të qytetarëve, Kuvendi i KA të Vojvodinës, më 23 Dhjetor të vitit 2004, ka themeluar ombudsmanin krahinor, i cili veç tjerash merret edhe me të drejtat e pakicave nacionale.

26 Neni 121. i Ligjit për vetqeverisje lokale.

Më në fund, në bazë të nenit 12. të këtij ligji për vetqeverisje lokale, njësitë e vetqeverisjes lokale mund të bashkohen për shkak të realizimit të planeve dhe programve për zhvillim, si dhe realizimin e nevojave tjera me interes të përbashkët, e iu është mundësuar edhe që të themelojnë edhe shoqatat e veta, bashkëpunimin me njësitë e vetqeverisjes lokale në shtetet tjera dhe të bashkangjiten në organizata ndërnacionale.

Sipas nenit 118 të Ligjit për vetqeverisje lokale në hapësirat zyrtare të njërive të vetqeverisjes lokale mund të theksohen simbolet shtetërore dhe simbolet e njërive të vetqeverisjes lokale. Por, sipas Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, i cili duhet të jetë në sistemin ligjor të shtetit „më i vjetër“ respektivisht me më shumë fuqi, duke pasur parasysh se e ka votuar parlamenti federal i dikurshëm, është paraparë në nenin 16. që „simbolet dhe shenjat e pakicave nacionale mund të theksohen zyrtarisht gjatë festave shtetërore dhe festave të pakicave nacionale në ndërtesat dhe në hapësirat e organizatave lokale me autorizime publike në vendet në të cilat gjuha e pakicës nacionale është në përdorim zyrtarë“. Më herët Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave nacionale e ka bërë ankesën kushtetuese gjyqit Kushtetues që këto dispozita të harmonizohen por nuk dihet nëse Gjyqi Kushtetues ka vendosur për këtë apo jo.

Më në fund, Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale përmban nenin i cili obligon organet e pushtetit, ashtu edhe të njërive të vetqeverisjes lokale, të bien rregulla dhe akte të veçanta juridike dhe të ndërmarrin masa për arritjen e plotë dhe efektive të barazisë në mes të pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të popullit shumicë.

Veçanërisht është theksuar që këto masa të ndërmerren në lidhje me përmirësimin e pozitës së personave që i takojnë pakicës nacionale rome. Në lidhje me ndërmarrjen e këtyre masave, njësitë e vetqeverisjes lokale do të jenë në mundësi të krijojnë

politikën lokale që duhet të sigurojë kushte për zhvillimin e disa bashkësive nacionale.

Në lidhje me këtë është e mundur që kuvendi i komunës të bie vendime të cilat do të tejkalojnë përmbajtjen e të drejtave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e identitetit të pakicave nacionale dhe të cilat janë të drejtuara kah sfera sociale-ekonomike. Në këtë kuptim duhet patur kujdes që anëtarët e këshillit për marrëdhënie ndërnacionale duhet të japin mendime jo vetëm për problemet shumë të ndieshme por edhe për çështjet e rrethit të gjerë të aktiviteteve të njësive të vetqeverisjes lokale.

Burimet tjera të mbrojtjes ligjore të të drejtave të pakicave nacionale në Serbi

- ◆ Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 45/91, 53/93, 67/93 dhe 48/94)
- ◆ Ligji për bazat e arsimit dhe edukimit („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 62/2003, 64/2003, 58/2004, 62/2004 dhe 79/2005)
- ◆ Ligji për mbrojtjen shoqërore të fëmijëve „Gazeta zyrtare e RS“, numrat 49/92, 29/93, 53/93, 67/93, 28/94, 47/94, 48/94, 25/96, 29/2001, 16/2002 dhe 62/2003)
- ◆ Ligji për shkollën fillore („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 50/92, 53/93, 67/93 dhe 48/94)
- ◆ Ligji për shkollën e mesme („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 50/92, 53/93, 67/93, 48/94, 24/96, 23/2002 dhe 25/2002)
- ◆ Ligji për shkollimin e lartë („Gazeta zyrtare e RS“, numër 76/2005)

Me hyrjen në furi kanë pushuar të vlejnjë Ligji për shkollën e lartë dhe Ligji për universitetin

- ◆ Ligji për tekstet dhe mjetet tjera mësimore („Gazeta zyrtare e RS“, numër 29/93)
- ◆ Ligji për aktivitetet me interes të përgjithshëm në lëminë e kulturës („Gazeta zyrtare e RS“, numër 49/92)
- ◆ Ligji për festat shetërore dhe festat tjera në Republikën e Serbisë („Gazeta zyrtare e RS“, numër 43/2001)
- ◆ Ligji për lejen personale („Gazeta zyrtare e SRS“, numrat 15/74, 54/77, 57/80, 45/85 dhe 40/88 dhe „Gazeta zyrtare e RS“, numrat 53/93, 67/93, 48/94, 17/99 dhe 33/99)
- ◆ Kodi penal („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 85/2005 dhe 88/2005)
- ◆ Ligji për informimin publik („Gazeta zyrtare e RS“, numrat 43/2003, dhe 61/2005)
- ◆ Ligji për zgjedhjen e deputetëve të popullit („Gazeta zyrtare e RS“, numrat: 35/2000, 69/2002, 57/2003, 72/2003, 18/2004 dhe 85/2005)
- ◆ ZLigji për aktivitetet e bibliotekës („Gazeta zyrtare e RS“, numër 34/94)
- ◆ Ligji për përcaktimin e kompetencave të caktuara të krahinës autonome („Gazeta zyrtare e RS“, numër 6/2002)
- ◆ Ligji për mbrojtësin e qytetarëve (Gazeta zyrtare e RS, numër 79/2005)
- ◆ Vendimi për formularët shumëgjuhësor të certifikatave të librave amë dhe mënyra e regjistrimit në to („Gazeta zyrtare e KAV“, numrat 1/2001 dhe 8/2003)
- ◆ Vendimi i rregullimit më të afërm i çështjeve të vecanta të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës (Gazeta zyrtare e KAV“, numrat 8/2003 dhe 9/2003)

- ◆ Rregullorja për mënyrën e punës së kuvendit të elektorit për zgjedhjen e këshilleve të pakicave nacionale („Gazeta zyrtare e RSJ“, numër 41/2002)
- ◆ Dekreti për arsimimin e Këshillit të Republikës së Serbisë për pakica nacionale („Gazeta zyrtare e RS“, numër 104/2004)

CIP – Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд